

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

TREGTI

Niveli IV i KSHK
(2 vjeçar)

(Në drejtimin mësimor “Ekonomi-Biznes”)

Kodi: L6-IV-2023

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2023

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Tregti”, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor “Ekonomi-Biznes”.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Tregti”, Niveli IV i KSHK.**
 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Tregti”, niveli IV i KSHK
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Tregti”, niveli IV i KSHK
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Tregti”, niveli IV i KSHK
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Tregti”, niveli IV i KSHK.
- III. Plani mësimor për profilin “Tregti”, niveli IV i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Tregti”, niveli IV i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin mësimor “Tregti”, niveli IV i KSHK, të drejtimit “Ekonomi-Biznes”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Tregti”, niveli IV i KSHK, të drejtimit “Ekonomi-Biznes” është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon, zhvillimi dhe nxitja e aftësive së tyre për të menduar, krijuar dhe zgjidhur probleme në mënyrë të pavarur si dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar apo vetëpunësuar në veprimtari profesionale që lidhen me profilin e Tregtisë”*. Zhvillimi të nxënësit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimit emocionale, intelektuale dhe profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale i’u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset bashkëkohore e të perspektivës në fushën e llogarisë, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse si dhe vlerat e tyre morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Tregti”, niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Tregti”, niveli IV i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Tregti”, niveli IV i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Ekonomi-Biznes”, niveli III i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional;
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Tregti”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Tregti”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojnë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në profilin “Tregti”, niveli IV i KSHK.

Me përfundimin me sukses të arsimit profesional në profilin profesional “Tregti”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin e mëparshëm, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të planifikojë mjedisin, mjetet dhe pajisjet, për kryerjen e veprimtarisë tregtare, duke zbatuar bazën ligjore në fuqi në fushën e tregtisë.
- Të hulumtojë tregjet globale dhe konkurruese të blerjes.
- Të vendosë marrëdhënie biznesi me furnitorët.
- Të kryejë blerjet për biznesin.
- Të dokumentojë dhe regjistrojë blerjet, në kushtet e një tregu kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Të magazinonjë produktin.
- Të vendosë dhe ruajë marrëdhëniet me furnitorët.
- Të vendosë marrëdhënie me klientët.
- Të mbajë korrespondencë zyrtare në fushën e shitjeve, sipas rregullave ndërkombëtare dhe në gjuhë të huaj.
- Të përdorë mjete digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.
- Të ambalazhojë produktin.
- Të përgatisë produktin për shpërndarje.
- Të përgatisë dokumentacionin shoqëruar të produktit.
- Të mbledhë informacione për eksportin.
- Të kryejë shitjet në mënyrë elektronike, si dhe t’i dokumentojë ato.
- Të kryejë shitjet për biznesin.

- Të dokumentojë dhe regjistrojë shitjet, në kushtet e një tregu kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Të përpunojë reklamimet (ankesat) e klientëve.
- Të përditësojë faqen on-line, gjatë blerjes dhe shitjes që kryen ndërmarrja.
- Të prezantohet në panaire, duke kryer veprimet dhe bisedat e shitjes në panaire.
- Të kontabilizojë shitjet, blerjet dhe kostot në ndërmarrjen tregtare.
- Të kryejë regjistrimet kontabël në rastin e kthimeve të mallrave të blera e të shitura.
- Të llogaritë dhe dokumentojë TVSH-në.
- Të kryejë veprimet me tatimin mbi fitimin (TF).
- Të kryejë llogaritje të çmimit në ndërmarrjen tregtare.
- Të rregullojë marrëdhëniet me shtetin.
- Të komunikojë me etikë, në marrëveshje biznesi me klientët, sipas natyrës së tyre.
- Të pranojë kërkesat e klientëve dhe zgjidhë ankesat e tyre.
- Të zgjidhë konfliktet që mund të krijohen gjatë punës në ndërmarrjen tregtare
- Të përdorë kasën fiskale dhe atë "POS" terminale gjatë veprimtarisë tregtare.
- Të zgjidhë konfliktin në vendin e punës, pasi e ka identifikuar saktë atë.
- Të sigurojë cilësinë e mallrave dhe shërbimeve, duke ruajtur standardet e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.
- Të zbatojë rregullat dhe standardet e duhura të ruajtjes, magazinimit dhe transportit të produktit.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë zhvillimit të aktiviteteve tregtare.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin "Tregti", niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin "Tregti" niveli IV i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e nivelit menaxherial në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep nxënësit mundësi t'i drejtohet tregut të punës për t'u punësuar si në kompani tregtare, kompani prodhuese që realizojnë shitje, njësi shitjeje, njësi të shitjeve on-line, njësi shpërndarëse, kompani import-eksporti, kompani transporti, si dhe ndërmarrje të ndryshme private/shtetërore që ushtrojnë veprimtarinë në këtë drejtim. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e tregtisë.

Me përfundimin e suksesshëm të këtij niveli, nxënësi fiton njëkohësisht edhe diplomën e "Maturës shtetërore profesionale", me mundësi për vazhdimin e studimeve të larta universitare, si edhe të arsimit pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor "Tregti", niveli IV i KSHK.

Plani mësimor për profilin "Tregti", niveli IV i KSHK				
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimorë	Orët javorë/vjetorë	
			Klasa 12	Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	10/11 (360/ 396)	14/15 (448/ 480)

1		Gjuhë shqipe	1	1
2		Letërsi	1	1
3		Gjuhë e huaj	2	2
4		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(1)	(1)
5		Histori	1	1
6		Matematikë	2	2
7		Teknologji informimi e komunikimi	1	1
8		Gjeografi	1	-
9		Biologji	-	2
10		Fizikë	-	1
11		Shkenca sociale	-	1
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	1	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	8 (288)	10 (320)
1	L-17-408-23	Tregti	3	3
2	L-17-635-23	Ekonomi e përgjithshme	3	2
3	L-17-410-23	Kontabiliteti i ndërmarrjes tregtare	2	-
4	L-17-553-23	Sjellje konsumatore	-	2
5	L-17-637-23	Sistemi tatimor	-	2
6	L-05-198-12	Mjedi dhe zhvillimi i qëndrueshëm		1
C.		Module të detyruara të praktikës profesionale (Gjithsej)	9 (324)	6 (192)
1	M-17-1987-23	Planifikimi dhe organizimi në ndërmarrjen tregtare	72	-
2	M-17-1265-23	Veprime të blerjes	72	-
3	M-17-1266-23	Veprime të shitjes	72	-
4	M-17-1267-23	Prezantimi në panairë	54	-
5	M-17-1271-23	Llogaritja dhe kontabilizimi në ndërmarrjen tregtare	54	-
6	M-17-1984-23	Komunikimi dhe zgjidhja e problemeve	-	30
7	M-17-1270-20	Kujdesi ndaj klientit në ndërmarrjen tregtare	-	33
8	M-17-1707-20	Përdorimi i kasës fiskale dhe "POS" terminal		30
9	M-17-1273-20	Hartimi i kontratave në ndërmarrjen tregtare	-	33
10	M-17-1272-16	Procedurat në transportin e mallrave		33
11	M-17-1988-23	Zbatimi i rregullave për cilësinë, sigurinë dhe mjedisin	-	33
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (108)	-
1	M-17-1274-16	Logjistika e eksport-importit	54	-
2	M-17-1275-16	Hulumtimi i tregut	54	-
3	M-17-1276-23	Menaxhimi i të dhënave	54	-
4	M-17-1268-16	E-Tregti	54	
5	M-26-1580-19	Marketingu dixhital	54	-
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1080/ 1116)	30/31 (960/ 992)

IV. Udhëzime për planin mësimor.

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Tregti”, niveli IV i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për profilet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme. E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës. Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit. Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Tregti”, niveli IV i KSHK. Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm në profilin profesional “Tregti”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre. *Në klasën 12*, modulet e praktikës profesionale mund të zhvillohen në zyrën

mësimore në shkollë ose në praktikat në biznes. Është e domosdoshme, që mësuesi të informojë nxënësit për mënyrën e organizimit të praktikës profesionale kur realizohet në ndërmarrje reale. Gjithashtu, duhet të jepet edhe informacion edhe kur praktika profesionale realizohet në ambientet e shkollës që gjatë zhvillimit të punës në zyrën mësimore , nxënësit do të punojnë duke imituar një ndërmarrje tregtare reale. Kryefjala është: NDËRVEPRIM. Ndërmarrja është një sistem. Nëse, deri tani, veprimtaria e saj, në një farë mënyre, është “copëtuar” vetëm për qëllime metodologjike dhe çdo kompetencë është trajtuar me anë të një moduli të veçantë, këtë vit modulet e praktikës do të trajtohen nga pikëpamja metodologjike, në mënyrë të tillë që, nxënësit të kuptojnë që ndërmarrja është një sistem, në të cilin pa bashkëveprim të të gjitha hallkave, faktorëve dhe aktorëve nuk mund të veprohet. Nxënësit në këtë mënyrë sillen në situatën më të afërt të mundshme me realitetin, duke ushtruar kompetencat e fituara më parë dhe duke fituar kompetenca të reja. Në se kjo situatë është aq afër, sa nuk mund të dallohet prej tij, apo në se i paraprin realitetit ekonomik shqiptar duke ecur para tij, kjo ka mundësi të vendoset në pavarësi nga çdo mësues që zhvillon mësimin në zyrë mësimore/klasë apo praktikat në biznes, duke pasur parasysh dhe nivelin e saj.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Tregti”, niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimeve të Maturës shtetërore profesionale (sipas udhëzimeve të MAS dhe MFE)
- b) Provimit të praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit njohurive nga lëndët teorike, të përgjithshme dhe profesionale, si dhe të kompetencave profesionale, të nevojshme për të punuar në fushën e ekonomisë dhe të administrimit të njësive ekonomike.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin “Tregti”, niveli IV i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Tregti”, niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, me Certifikatën profesionale të nivelit IV të KSHK, si dhe me suplementin përkatës, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modeleve të miratuara nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.;
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale të klasës 13;
 - rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të Integruar.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Tregti” (L-17-408-23). Kl. 12 – 108 orë dhe Kl. 13 – 96 orë

- Synimet e lëndës “Tregti”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Tregti”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë e tregtisë dhe fazat e ndryshme në historinë e zhvillimit të saj.
- Të analizojnë llojet e ndërmarrjeve tregtare (tregtare, ndërmjetësuese, shpërndarëse, transportuese, magazinuese dhe agjencitë tregtare), mënyrën e organizimit dhe administrimit të tyre.
- Të shpjegojnë rëndësinë e organizimit ergonomik të vendit të punës.
- Të shpjegojnë rëndësinë e përdorimit të programeve për tregtimin e mallrave (të mirave) dhe shërbimeve.
- Të përshkruajnë veçoritë e tregtisë me pakicë dhe me shumicë.
- Të përshkruajnë nocionin “mall”, vetitë dhe karakteristikat e mallrave lidhur me prejardhjen, dizajnin, standardizimin, cilësinë, ambalazhimin, etiketimin, magazinimin, ruajtjen dhe mënyrën e transportimit të tyre.
- Të përshkruajnë veçoritë e mallrave ushqimore bazë dhe produkteve që rrjedhin prej tyre.
- Të përshkruajnë nocionin “shërbim”, karakteristikat dhe standardizimin e tyre.
- Të përcaktojnë produktin që do të marketohet.
- Të përshkruajnë veçoritë e produktit dhe ciklit të jetës së tij.
- Të shpjegojnë mënyrat e promovimit të aktivitetit në media të ndryshme.
- Të shpjegojnë rëndësinë e zbatimit të politikave lidhur me çmimin.
- Të përshkruajnë mënyrat dhe rëndësinë e prezantimit të shërbimeve që ofrohen.
- Të listojnë mënyrat dhe mjetet e ekspozimit të mallrave dhe shërbimeve.
- Të shpjegojnë mënyrat e llogaritjes së nevojave për blerje.
- Të përshkruajnë procedurat e përzgjedhjes së furnitorëve në varësi të blerjeve.
- Të shpjegojnë rëndësinë e krijimit dhe mbajtjes së bazës së të dhënave të furnitorëve.
- Të rendisin hapat për kryerjen e procesit të blerjes.
- Të shpjegojnë rregullat dhe rëndësinë për kryerjen e kontrollit fizik të produkteve të blera.
- Të listojnë llojet e dokumenteve për marrjen në dorëzim të produkteve/shërbimeve dhe mënyra e plotësimit të tyre.
- Të shpjegojnë mënyrën e përzgjedhjes së bizneseve për blerjet on-line të produkteve.
- Të përshkruajnë rëndësinë e informacionit të nevojshëm për klientët dhe të bazës së të dhënave për klientët realë dhe potencialë.
- Të shpjegojnë elementët dhe mënyrat e llogaritjes së shpenzimeve të lidhura me shitjen (kosto, transport, garanci, montim, mirëmbajtje).
- Të shpjegojnë llojet e dokumenteve përcjellëse të produkteve, përmbajtjen dhe plotësimin e tyre.
- Të shpjegojnë mënyrat e përpunimit të porosive të ardhura on-line.
- Të përshkruajnë hapat dhe procedurat për dërgimin e produkteve të porositura.
- Të shpjegojnë mënyrat e menaxhimit të ankesave/refuzimeve nga klientët.
- Të tregojnë mënyrat e rimbursimit të klientëve.
- Të përshkruajnë llojet e transportit dhe rëndësinë e tij.
- Të përshkruajnë përgatitjen e mallit për transport.
- Të shpjegojnë nocionin “standard”, për sigurimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të standardizuara.

- Të përshkruajnë rregullat dhe standardet e ruajtjes, magazinimit dhe transportit të produktit.
- Të argumentojnë nevojën dhe rolin e kontrollit të cilësisë.
- Të shpjegojnë rëndësinë e zbatimit të rregullave të higjienës.
- Të argumentojnë mënyrat e kontrollit të gjendjes fizike të produkteve për shitje.
- Të shpjegojnë procedurat për evidentimin dhe trajtimin e mallrave të skaduar.
- Të përshkruajnë elementët e etiketës dhe rëndësinë e zbatimit të informacionit.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Tregti”, klasa 12 - 108 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi tregtinë	10 orë
Tema 2	Ndërmarrjet tregtare	7 orë
Tema 3	Format e qarkullimit të mallrave	8 orë
Tema 4	Mallrat dhe shërbimet	7 orë
Tema 5	Funksionet dhe teknikat e blerjes	5 orë
Tema 6	Furnitorët dhe negocimi me ta	7 orë
Tema 7	Procesi i blerjes	9 orë
Tema 8	Funksionet dhe teknikat e shitjes	5 orë
Tema 9	Klientët dhe negocimi me ta	7 orë
Tema 10	Procesi i shitjes	9 orë
Tema 11	Transporti	7 orë
Tema 12	Shpërndarja	8 orë
Tema 13	Kontrolli i cilësisë	10 orë
Tema 14	Sigurimi i produktit	9 orë

• **Synimet e lëndës “Tregti”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Tregti”, klasa 13, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë funksionet dhe llojet e tregjeve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Të identifikojnë elementet kryesorë mbi të cilat zhvillohet tregu.
- Të përshkruajnë lloje të ndryshme të strukturave organizative të funksionimit të biznesit tregtar, natyrën, karakteristikat e veprimtarisë së tyre, ndryshimet dhe marrëdhëniet me të tretë.
- Të shpjegojnë rëndësinë e përshkrimit të vendit të punës (job description) dhe të zbatimit të detyrave.
- Të shpjegojnë rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe planifikimit të veprimtarisë tregtare.
- Të argumentojnë rëndësinë e zbatimit të bazës ligjore në fushën e tregtisë.
- Të identifikojnë mundësitë e karrierës në sektorin tregtar (agjent tatimor - doganor, qendra tregtare, menaxher i vetëpunësuar, shitës etj).
- Të dallojnë llojet e kontratave të punësimit në ndërmarrjet tregtare.
- Të identifikojnë llojet dhe mënyrat e pagesave në ndërmarrjet tregtare.
- Të shpjegojnë procedurat e kryerjes së pagesave (cash, karta krediti/debiti) dhe transfertave on-line.
- Të shpjegojnë përdorimet e valutave dhe llogaritjen e kursit të këmbimit të tyre.
- Të shpjegojnë rëndësinë e përdorimit të TIK-ut në ndërmarrjet tregtare.
- Të shpjegojnë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale dhe në gjuhë të huaj.
- Të shpjegojnë parimet bazë të kodit të etikës, të punës në grup dhe të komunikimit verbal dhe jo verbal.
- Të listojnë llojet dhe metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik.

- Të përshkruajnë fazat e ndryshme në historinë e zhvillimit të tregtisë ndërkombëtare dhe rolin e saj në ekonominë e vendit tonë.
- Të përshkruajnë nocionin dhe regjimet e ndryshme të kursit të këmbimit.
- Të shpjegojnë qartë kuptimin e tregtisë së brendshme dhe tregtisë së jashtme (eksportin dhe importin), si dhe rëndësinë e tyre për ekonominë e vendit.
- Të analizojnë faktorët e globalizimit dhe veçoritë e bashkëpunimeve nëpërmjet tregut ndërkombëtar.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Tregti”, klasa 13 - 96 orë**

Tema 1	Tregu dhe format e tij	6 orë
Tema 2	Organizimi dhe drejtimi i ndërmarrjes tregtare	9 orë
Tema 3	Rregullat e sigurisë në punë në ndërmarrjet tregtare	9 orë
Tema 4	Punësimi në ndërmarrjet tregtare	8 orë
Tema 5	Mënyrat e pagesave në ndërmarrjet tregtare dhe teknologjia e tyre	8 orë
Tema 6	Teknologjia dhe inovacioni në tregti (E-commerce)	8 orë
Tema 7	Komunikimi në ndërmarrjet tregtare	10 orë
Tema 8	Etika në ndërmarrjet tregtare	6 orë
Tema 9	Tregtia ndërkombëtare dhe zhvillimi ekonomik	10 orë
Tema 10	Kursi i këmbimit	5 orë
Tema 11	Eksporti dhe importi	9 orë
Tema 12	Tregtia dhe globalizimi	8 orë

2. Lënda “Ekonomi e përgjithshme” (L-17-635-23) Kl. 12 – 108 orë dhe Kl. 13 – 64 orë

• **Synimet e lëndës “Ekonomi e përgjithshme”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Ekonomia e tregut”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë objektin e shkencës ekonomike.
- Të identifikojnë problemin kryesor të ekonomisë dhe konceptin e “pamjaftueshmërisë”.
- Të përshkruajnë konceptet kryesore të tregut, si kërkesa dhe oferta.
- Të llogarisin elasticitetin e kërkesës dhe ofertës në lidhje me çmimin.
- Të shpjegojnë ekuilibrin e tregut si dhe rastet e ndryshimit të çmimit dhe sasisë ekuilibër.
- Të identifikojnë ndryshime të ekuilibrit të tregut, si rrjedhojë e vendosjes së taksave dhe subvencioneve.
- Të shpjegojnë procesin vendimmarrës për të konsumuar ose kursyer.
- Të arsyetojnë sesi mund të rritet pasuria në varësi të kursimit.
- Të interpretojnë dobinë si koncept ekonomik.
- Të përshkruajnë ligjin e dobisë marxhinale zbritëse.
- Të përcaktojnë ekuilibrin e konsumatorit.
- Të argumentojnë maksimizimin e dobishmërisë.
- Të dallojnë format e klasifikimit të biznesit.
- Të përshkruajnë rolin ekonomik të firmave dhe format ligjore të tyre.
- Të argumentojnë qëllimet dhe format e burimeve financiare të biznesit.
- Të rendisin hapat për hartimin e një plan biznesi.
- Të hartojnë një plan biznesi.
- Të përshkruajnë prodhimin si veprimtari me qëllim fitimin.
- Të përkufizojnë treguesit kryesor të prodhimit.
- Të përshkruajnë tipologjitë e kostove (fikse, të ndryshueshme, e shprehur, e nënkuptuar).

- Të evidentojnë dallimin ndërmjet kostove fikse dhe kostove të ndryshueshme.
- Të llogarisin koston e përgjithshme të prodhimit, koston mesatare dhe atë marxhinale.
- Të llogarisin të ardhurat e përgjithshme, marxhinale dhe mesatare.
- Të llogarisin fitimin e firmës (normal, kontabël, ekonomik).
- Të përkufizojnë prodhueshmërinë e firmës.
- Të identifikojnë faktorët që përcaktojnë prodhueshmërinë.
- Të shpjegojnë funksionin e prodhimit.
- Të evidentojnë dallimet midis periudhës afatshkurtër dhe periudhës afatgjatë.
- Të shpjegojnë ligjin e të ardhurave rënëse.
- Të argumentojnë veprimin e ligjit në periudhë afatshkurtër.
- Të dallojnë strukturat e ndryshme të tregut dhe tiparet kryesore të tyre.
- Të analizojnë efektet ekonomike të strukturave të ndryshme të tregut.
- Të evidentojnë rolin e rregullimit shtetëror në strukturën e tregut monopol.
- Të interpretojnë ofertën dhe kërkesën për faktorët e prodhimit, sipas llojeve të tyre.
- Të shpjegojnë funksionin e qeverisë si arbitër, menaxher dhe lojtar në ekonominë e tregut.
- Të shpjegojnë shpenzimet dhe të ardhurat në buxhetin e shtetit.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ekonomi e përgjithshme”, kl.12 - 108 orë**

Tema 1	Objekti i shkencës ekonomike	10 orë
Tema 2	Kërkesa, oferta, funksionimi i tregjeve dhe ekuilibri i tyre	12 orë
Tema 3	Konsumatorë dhe kursyes	6 orë
Tema 4	Sjellja konsumatore dhe maksimizimi i dobishmërisë	12 orë
Tema 5	Fillimi një biznesi dhe financimi i tij	12 orë
Tema 6	Prodhimi, kostoja, të ardhurat dhe fitimi i firmës	12 orë
Tema 7	Produktiviteti, funksioni i prodhimit, periudhat	8 orë
Tema 8	Strukturat e tregut, analizë krahasuese	12 orë
Tema 9	Tregjet e faktorëve të prodhimit	12 orë
Tema 10	Roli i qeverisë në ekonomi	12 orë

• **Synimet e lëndës “Ekonomi e përgjithshme”, klasa 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Ekonomi e përgjithshme”, klasa 13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë ofertën monetare dhe rolin e sistemit bankar në krijimin e saj.
- Të identifikojnë llojet dhe funksionet e parasë.
- Të dallojnë variablat makroekonomike.
- Të kryejnë dallimin dhe lidhjen midis produktit kombëtar bruto (PKB) dhe produktit të brendshëm bruto (PBB).
- Të llogarit treguesit e koston së jetesës.
- Të dallojnë metodat e llogaritjes së produktit të brendshëm bruto (PBB).
- Të përshkruajnë papunësinë, llojet dhe mënyrat e matjes së saj.
- Të përshkruajnë ciklin e biznesit dhe fazat e tij.
- Të dallojnë kostot ekonomike e sociale që shkakton papunësinë.
- Të përshkruajnë konceptin e inflacionit, faktorët që ndikojnë në të dhe kostot që shkakton.
- Të përshkruajnë kuptimin e kërkesës dhe ofertës agregate.
- Të përshkruajnë kuptimin e politikës monetare dhe atë fiskale.
- Të dallojnë politikën monetare nga ajo fiskale.

- Të përshkruajnë instrumentet e politikës monetare dhe fiskale.
- Të dallojnë përparësitë absolute dhe krahasuese.
- Të shpjegojnë thelbin e bashkëpunimit ekonomik.
- Të evidentojnë fazat integruese.
- Të përshkruajnë kuptimin e politikave tregtare dhe rolin e organizmave ndërkombëtare të tregtisë.
- Të përkufizojnë kuptimin për tregun valutor.
- Të identifikojnë faktorët që ndikojnë kursin e këmbimit.
- Të identifikojnë përfitimet e sipërmarrjes në shoqëri dhe ndikimin që sjell në zhvillimin ekonomik.
- Të përcaktojnë rolin e sipërmarrjes sociale dhe ekonomike në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme.
- Të identifikojnë aftësi sipërmarrëse për një karrierë të suksesshme.
- Të evidentojnë elementët themelorë të burimeve financiare personale, si të ardhurat, kursimet dhe investimet, buxhetimi, etj.
- Të ndërtojnë një plan personal financiar.
- Të përshkruajnë metodat e zhvillimit profesional dhe zhvillimit të karrierës.
- Të përzgjedhin metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës.
- Të përgatisin planin e zhvillimit të karrierës për të ardhmen e tij/saj.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ekonomi e përgjithshme”, kl. 13 - 64 orë**

Tema 1	Institucionet financiare dhe roli i parasë në ekonomi	10 orë
Tema 2	Treguesit kryesorë makroekonomik	10 orë
Tema 3	Politikat stabilizuese makroekonomike	10 orë
Tema 4	Bashkëpunimi ekonomik dhe proceset integruese	8 orë
Tema 5	Tregtia ndërkombëtare	8 orë
Tema 6	Sipërmarrja dhe suksesi	8 orë
Tema 7	Menaxhimi i financave personale	4 orë
Tema 8	Zhvillimi profesional dhe karriera	6 orë

3. Lënda “Kontabiliteti i ndërmarrjes tregtare ” (L-17-410-23), Kl. 12 - 72 orë

• **Synimet e lëndës “Kontabiliteti i ndërmarrjes tregtare”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Kontabiliteti i ndërmarrjes tregtare”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë bazën ligjore për shërbimin e kontabilitetit në shoqëritë tregtare dhe rëndësinë e mbajtjes së kontabilitetit.
- Të identifikojnë të drejtat dhe detyrimet në ndërmarrjet tregtare.
- Të përshkruajnë strukturën e të ardhurave dhe shpenzimeve në ndërmarrjet tregtare.
- Të dallojnë llojet e të ardhurave dhe shpenzimeve në ndërmarrjet tregtare.
- Të tregojnë llojet e kostove në ndërmarrjet tregtare, duke dalluar kostot fikse nga kostot e ndryshueshme.
- Të përshkruajnë llojet e kostove të magazinimit të mallrave dhe shpenzimet përkatëse.
- Të përshkruajnë elementet e çmimit të produkteve që ofrohen në ndërmarrjet tregtare.
- Të llogarisin çmimin e produkteve në tregtinë me shumicë dhe pakicë.
- Të llogarisin çmimin e produkteve në ndërmarrjet tregtare import dhe eksport.

- Të llogarisin marzhin e llojeve të produkteve në ndërmarrjet tregtare (me shumicë dhe pakicë).
- Të shpjegojnë rëndësinë e mbajtjes së evidencës së blerjeve dhe shitjeve.
- Të kontabilizojnë veprimet në lidhje me kthimet dhe uljet e blerjeve dhe kthime dhe ulje të shitjeve, kostot e mallrave të shitura etj.
- Të shpjegojnë mënyrën e deklarimit on-line të librit të blerjes dhe shitjes.
- Të përshkruajnë llojet e taksave dhe tatimeve që aplikohen, sipas llojeve dhe formave të ndërmarrjeve tregtare.
- Të kontabilizojnë tatimet dhe taksat në ndërmarrjet tregtare.
- Të përshkruajnë mënyrat dhe procedurat e rregullimit të marrëdhënieve me shtetin.
- Të tregojnë rëndësinë e mbajtjes së evidencës së blerjeve dhe shitjeve.
- Të tregojnë hapat e deklarimit on-line të librit të blerjes dhe shitjes.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Kontabiliteti i ndërmarrjes tregtare”, klasa 12 – 72 orë**

Tema 1	Baza ligjore për shërbimin e kontabilitetit në shoqëritë tregtare	4 orë
Tema 2	Të drejtat dhe detyrimet në ndërmarrjet tregtare	6 orë
Tema 3	Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve në ndërmarrjet tregtare	8 orë
Tema 4	Kostot në ndërmarrjet tregtare dhe llojet e tyre	8 orë
Tema 5	Elementet e çmimit të produkteve në ndërmarrjet tregtare	4 orë
Tema 6	Llogaritja e çmimit të produkteve në ndërmarrjet tregtare	10 orë
Tema 7	Kontabilizimi i shitjeve në ndërmarrjet tregtare	6 orë
Tema 8	Kontabilizimi i blerjeve në ndërmarrjet tregtare	8 orë
Tema 9	Kontabilizimi i tatimeve dhe taksave në ndërmarrjet tregtare	10 orë
Tema 10	Rregullimi i marrëdhënieve me shtetin	8 orë

4. Lënda “Sjellje konsumatore” (L-17-553-23), Kl. 13 - 64 orë

• **Synimet e lëndës “Sjellje konsumatore”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Sjellje konsumatore”, klasa 13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë evoluimin e sjelljes konsumatore nën ndikimin e teknologjisë dhe lidhjen e saj me vendim-marrjen marketing.
- Të shpjegojnë ndikimin e elementëve psikologjikë në sjelljen konsumatore.
- Të shpjegojnë rëndësinë dhe rolin e imazhit të njërive tregtare, si dhe zhvillimit të promocionit në media të ndryshme, për nxitjen e konsumatorit.
- Të shpjegojnë ndikimin e mjedisit në vendimmarrjen e konsumatorëve.
- Të shpjegojnë rolin e sipërmarrjes sociale dhe ekonomike në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme.
- Të shpjegojnë rolin e kulturës në krijimin e stileve të vendimmarrjes konsumatore.
- Të përshkruajnë rolin e familjes dhe grupeve të referencës në sjelljen konsumatore.
- Të shpjegojnë rëndësinë e respektimit të parimeve të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.
- Të argumentojnë rolin e kërkimit konsumator në studimin e sjelljes konsumatore.
- Të dallojnë termat “luks”, “dëshirë”, “nevojë”.
- Të analizojnë elementët që ndikojnë në tërheqjen e konsumatorëve në blerjen e re dhe blerjen e përsëritur;
- Të shpjegojnë risitë e teknologjisë në tregti.

- Të shpjegojnë rolin e shkëmbimit fizik dhe on-line, në përmirësimin e mirëqënies së njerëzve.
- Të përshkruajnë veçoritë e produktit dhe ciklit të jetës së tij.
- Të evidentojnë ndryshimet midis të mirave dhe shërbimeve në këndvështrimin e procesit të blerjes fizike dhe on-line.
- Të analizojnë sjelljen konsumatore, sipas llojeve të blerjeve, si dhe gjenerimin e kënaqësisë dhe moskënaqësisë gjatë dhe pas blerjes.
- Të shpjegojnë nevojën dhe ndikimin e teknologjisë në segmentimin e tregut.
- Të analizojnë mënyrat e uljes së riskut gjatë blerjes së shërbimeve on-line.
- Të tregojnë të drejtat e konsumatorit për sigurinë e produktit.
- Të analizojnë ndikimin e sjelljes konsumatore në e-marketing.
- Të shpjegojnë strategjitë e marketingut miks, hapat e tij, si dhe nevojën për bashkëpunim me të tretët për zhvillimin e tij.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Sjellje konsumatore”, klasa 13 - 64 orë**

Tema 1	Rëndësia e kuptimit të sjelljes konsumatore	4 orë
Tema 2	Ndikimi i elementëve psikologjikë në sjelljen konsumatore	6 orë
Tema 3	Mjedisi, klasat dhe kultura	5 orë
Tema 4	Grupet e referencës dhe familja	6 orë
Tema 5	Vendimmarrja konsumatore	7 orë
Tema 6	Risitë në tregti	5 orë
Tema 7	Sjellja gjatë dhe pas blerjes	10 orë
Tema 8	Segmentimi nëpërmjet sjelljes	6 orë
Tema 9	Tregjet e shërbimeve	6 orë
Tema 10	Sjellja konsumatore dhe marketingu miks	9 orë

5. Lënda “Sistemi tatimor” (L-17-637-23), Kl. 13 - 64 orë

• **Synimet e lëndës “Sistemi tatimor”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Sistemi tatimor”, klasa 13, nxënësit duhet:

- Të interpretojnë legjislacionin tatimor në ndërmarrjet tregtare.
- Të përshkruajnë karakteristikat e tatimeve dhe taksave në ndërmarrjet tregtare.
- Të përshkruajnë rolin, detyrat dhe funksionet e organeve qendrore tatimore e lokale.
- Të shpjegojnë konceptet e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimit mbi të Ardhurat Personale (TAP), Tatimin mbi Fitimin (TF), kontributet nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, llogaritjen dhe deklarimin e tyre.
- Të përshkruajnë bazën ligjore për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimin mbi të Ardhurat Personale (TAP), Tatimin mbi Fitimin (TF), kontributet nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, llogaritjen dhe deklarimin e tyre.
- Të shpjegojnë rëndësinë e respektimit të afateve të pagesave të detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore.
- Të shpjegojnë rëndësinë e taksave lokale, si burime financiare për pushtetin vendor.
- Të përshkruajnë llojet e taksave lokale dhe rolin e organeve tatimore qendrore e lokale.
- Të përshkruajnë legjislacionin për sistemin doganor në Shqipëri.
- Të përshkruajnë doganat dhe rolin e tyre në tregtinë ndërkombëtare.
- Të identifikojnë dokumentacionin për importin dhe eksportin e mallrave në ndërmarrjet tregtare.

- Të përshkruajnë procedurën e paraqitjes, deklarimit dhe të verifikimit të mallrave që i nënshtrohen taksës doganore, si edhe rolin e agjentëve doganorë.
- Të tregojnë rolin e taksave dhe tarifave doganore në ekonominë e vendit.
- Të identifikojnë tarifatat doganore, duke i dalluar nga tarifatat preferenciale.
- Të tregojnë konceptin e akcizës dhe mallrat mbi të cilët aplikohet.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Sistemi tatimor”, klasa 13 - 64 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi taksimin	3 orë
Tema 2	Sistemi tatimor në Shqipëri	6 orë
Tema 3	TVSH: baza ligjore, kuptimi, regjistrimi dhe deklarimi	8 orë
Tema 4	Tatimi mbi të ardhurat personale (TAP)	5 orë
Tema 5	Tatimi mbi Fitimin	6 orë
Tema 6	Rëndësia e rregullimit të marrëdhënieve me shtetin	4 orë
Tema 7	Detyrimet fiskale lokale: bazat ligjore, llojet, roli i organeve tatimore qendrore dhe lokale	6 orë
Tema 8	Doganat dhe roli i tyre. Sistemi doganor në Shqipëri	6 orë
Tema 9	Procedurat e import-eksportit. Agjentët doganorë	8 orë
Tema 10	Taksat dhe tarifatat doganore.	6 orë
Tema 11	Akciza	6 orë

6. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12). Kl.13 – 32 orë

• **Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.**

Në përfundim të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”.
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojnë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor.
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13-32 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
Tema 2	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
Tema 3	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis	3 orë
Tema 4	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	3 orë
Tema 5	Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
Tema 6	Monitorimi i burimeve mjedisore	3 orë
Tema 7	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë

Tema 8	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
Tema 9	<u>Veprimtari praktike</u> për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal	3 orë
Tema 10	<u>Veprimtari praktike</u> për mbrojtjen e mjedisit lokal	6 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Planifikimi dhe organizimi në ndërmarrjen tregtare”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PLANIFIKIMI DHE ORGANIZIMI NË NDËRMARRJEN TREGTARE	M-17-1987-23
Qëllimi i modulit	Një modul praktik, që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të planifikuar mjedisin, mjetet dhe pajisjet, për kryerjen e veprimtarisë tregtare, duke zbatuar bazën ligjore në fuqi në fushën e tregtisë.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II, të KSHK, në drejtimin mësimor “Ekonomi-Biznes”.	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi planifikon mjedisin dhe mjetet për organizimin e punës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të planifikojë mjedisin për organizimin e punës;- të planifikojë mjetet dhe pajisjet për kryerjen e veprimtarisë tregtare;- të planifikojë kostot për krijimin dhe blerjet e pajisjeve/mjeteve të ndërmarrjes;- të hartojë skicat dhe planimetritë funksionale të aktivitetit tregtar;- të hartojë porosinë për pajisjet dhe mobiljet e nevojshme;- të hartojë dokumentacionin për marrjen në dorëzim dhe pasqyrimin e pajisjeve dhe mjeteve të zyrës;- të vendosë pajisjet dhe mobilet, sipas vendeve të punës ose planimetrisë së hartuar;- të organizojë mjetet dhe pajisjet në funksion të aktivitetit tregtar;- të përdorë programe për tregtimin e mallrave (të mirave) dhe shërbimeve;- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë punës për organizimin e vendeve të punës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.	

RN 2 Nxënësi organizon vendet e punës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë lista të detyrave, në varësi të llojit të aktivitetit tregtar;
- të hartojë lista të përgjegjësive në bazë të funksionit dhe rregullores së brendshme të ndërmarrjes;
- të caktojë grupet e punës për plotësimin e detyrave të veçanta, në bazë të vendit të punës dhe aftësive personale të secilit anëtar;
- të ndajë detyrat në grup;
- të zbatojë detyrat, sipas përshkrimit të vendit të punës;
- të planifikojë llojet e agjendave (ditore, javore, mujore);
- të përcjellë informacionin në mënyrë horizontale dhe vertikale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë punës për organizimin e vendeve të punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN3 Nxënësi kryen rekrutimin e personelit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të planifikojë nevojat për personel në aktivitetin tregtar;
- të hartojë kriteret e punësimit të personelit në aktivitetin tregtar;
- të përgatitë dokumentacionin për konkursin e pranimit të kandidatëve në aktivitetin tregtar;
- të përcaktojë kriteret e vlerësimit të kandidatëve;
- të shpallë njoftimet për vende pune;
- të përgatisë formularët e aplikimit për punë;
- të përgatisë dokumentacionin për aplikim të kandidatit (CV-në sipas formatit të Bashkimit Europian, referencat, letër aplikimi etj);
- të kryejë intervistën në rolin e aplikuesit për punë;
- të kryejë rolin e intervistuesit të kandidatëve;
- të kryejë vlerësimin e kandidatëve;
- të kryejë përzgjedhjen dhe caktimin e personelit nëpër sektorë;
- të përgatisë dhe të plotësojë kontratat e punës;
- të komunikojë me korrektesi dhe etikë profesionale;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 4 Nxënësi përcakton nevojat për trajnime dhe kualifikime të personelit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë saktë nevojat për kualifikime të personelit, sipas sektorëve, vendeve të punës dhe profesioneve;
- të hartojë lista të plota të personave që do të kualifikohen dhe të profesioneve përkatëse në ndërmarrjen tregtare;
- të hartojë lista të plota të veprimtarive kualifikuese dhe ri-kualifikuese;
- të hartojë një plan të qartë kualifikimi për personelin e ri;
- të hartojë një plan të qartë ri-kualifikimi për personelin ekzistues në ndërmarrjen tregtare;
- të llogarisë saktë kostot paraprake të veprimtarive kualifikuese;
- të komunikojë me korrektësi dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e zyrës mësimore ose praktika në biznes.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për planifikimin e personelit, rekrutimin, punësimin, kualifikimin, dhe dokumentimin e tij në ndërmarrje, si dhe kryerjen e punëve sipas sektorëve të ndërmarrjes tregtare.
- Nxënësit duhet të përdorin Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për planifikimin e personelit, rekrutimin, punësimin, kualifikimin, dokumentimin e tij në ndërmarrje, si dhe kryerjen e punëve, sipas sektorëve të ndërmarrjes tregtare.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve, për të planifikuar mjedisin, mjetet dhe pajisjet, për kryerjen e veprimtarisë tregtare, duke zbatuar bazën ligjore në fuqi në fushën e tregtisë.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së ambientit dhe pajisjeve në ndërmarrjen tregtare.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Materiale kancelarie.
 - Dokumente të ndryshme dhe formate të gatshme.
 - Përmbledhje legjislacioni në fushën e punës dhe të sigurimeve.
 - Kompjuter.
-

2. Moduli “Veprime të blerjes”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	VEPRIME TË BLERJES	M-17-1265-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer procedurat e blerjes, për të dokumentuar dhe regjistruar ato, në kushtet e një tregu kombëtar dhe ndërkombëtar.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në drejtimin mësimor “Ekonomi - Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi vendos marrëdhënie biznesi me furnitorët. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përcaktojë nevojat për blerje për fillimin e aktivitetit tregtar;- të kërkojë informacione mbi ndërmarrjet tregtare në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar;- të identifikojë saktë furnitorët potencialë për veprimtarinë e biznesit;- të vlerësojë besueshmërinë e furnitorëve on-line;- të përzgjedhë bizneset për shitje/blerje on-line të produkteve;- të kontaktojë furnitorët potencialë dhe të sigurojë informacione për ta;- të hartojë lista të qarta dhe të plota të furnitorëve potencialë, të evidentuar nga kërkimi, si dhe kontaktet me to;- të shqyrtojë dhe përditësojë kartelat e furnitorëve të biznesit;- të komunikojë dhe mbajë korrespondencë zyrtare në fushën e blerjeve, duke përdorur terminologji profesionale në gjuhë amtare dhe të huaj;- të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;- të kërkojë oferta e lista çmimesh për artikuj të veçantë, të cilët nuk mund të sigurohen në tregun e ngushtë;- të krijojë një bazë të dhënash elektronike me informacione të detajuara mbi marrëdhëniet me furnitorët (mallrat dhe shërbimet që ofrojnë, kushtet e lëvrimit dhe pagesave etj);	

-
- të përditësojë bazën e të dhënave elektronike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 2 Nxënësi përgatit planin e blerjes.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë objektivat e planit të blerjes;
- të vlerësojë nevojat për blerje për biznesin bazuar në objektivat e planit të blerjes;
- të krahasojë ofertat e furnitorëve potencialë dhe të evidentojë ofertën më të përshtatshme për biznesin;
- të hartojë planin e blerjes dhe të ndjekë realizimin e tij;
- të hartojë saktë formularët e njoftimit të nevojave për blerje, duke vlerësuar gjendjen e magazinës;
- të plotësojë saktë formularët e blerjes që do t'i përcillen furnitorit;
- të hartojë porositë, sipas furnitorëve të ndryshëm;
- të kryejë përshkrimin e saktë të produkteve të kërkuara, lidhur me sasinë, cilësinë etj;
- të formulojë në mënyrën e duhur kërkesat për kushtet dhe afatet e lëvrimin të mallit/mallrave të kërkuara;
- të kryejë rishikimin dhe kontrollin e dokumenteve të hartuar për verifikimin e gabimeve të mundshme përmbajtësore, gramatikore, të formatimit etj;
- të përdorë modelet e gatshme (templates) të ofruara;
- të zbatojë rregullat e drejtshkrimit dhe formatimit;
- të zbatojë teknologjitë e reja për të arritur një komunikim të suksesshëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë punës për organizimin e vendeve të punës së njësisë tregtare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 3 Nxënësi kryen blerjet për biznesin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë urdhra blerjeje;
- të kryejë saktë porosinë për blerje;
- të regjistrojë saktë porosinë në regjistrin e porosive të kryera;
- të regjistrojë saktë dëftesën e lëvrimit dhe faturën e mallrave të blera për veprimtarinë e biznesit;
- të kryejë kontrollet e plota formale të dokumenteve për mallrat e blera;
- të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për import, duke respektuar afatet;
- të kryejë kontrollin e përputhjes së porosisë me dëftesën e lëvrimit dhe faturën;
- të plotësojë llojet e dokumenteve për marrjen në dorëzim të produkteve/shërbimeve;
- të përcjellë në kohë dokumentet e blerjeve në zyrën e kontabilitetit;
- të identifikojë forma të ndryshme të pagesave (çek, kartë krediti, para në dorë etj);
- të kryejë pagesa me çek, kartë krediti, para në dorë etj, duke zbatuar të gjitha procedurat e sigurisë;
- të përdorë valutat në veprimet tregtare;
- të kryejë llogaritje me kursin e këmbimit për veprimet në valuta;
- të kryejë pagesa dhe transferta on-line;
- të zbatojë procedurat e duhura, në rast të evidentimit të diferencave në sasi dhe cilësi të mallrave dhe shërbimeve të blera;
- të hartojë procesverbalet, sipas rastit;
- të hartojë saktë dhe në kohën e duhur dhe dërgojë reklamimet për mallrat, që nuk përputhen me kontratat ose janë të dëmtuara;
- të përpunojë reklamimet në momentin e dërgimit dhe të marrjes së përgjigjes nga furnitorët;
- të zbatojë rregullat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
- të dërgojë me postë ose e-mail, konfirmimet për marrjen e mallit në dorëzim, në kohën e duhur;
- të regjistrojë saktë blerjet në kartelat e furnitorëve;
- të regjistrojë saktë në kartelat e furnitorëve reklamimet e kryera në momentin e dërgimit dhe të marrjes së përgjigjes për pranimin ose jo të tyre;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen blerje për biznesin on-line.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hyjë në faqe të ndryshme web-i, duke ndjekur procedurën e saktë;
- të kërkojë dhe të shfrytëzojë me efikasitet informacione, duke përdorur filtrin e kërkimit;
- të identifikojë saktë produktet që do të porositen;
- të krahasojë ofertat dhe kushtet e lëvrimit e të pagesës së tyre;
- të kryejë porosinë në faqe web-i;
- të printojë porosinë e kryer dhe ruajë atë;
- të regjistrojë saktë porosinë në regjistrin e porosive të kryera;
- të përcjellë porosinë për përdorime të mëtejshme në kohën e duhur;
- të identifikojë forma të ndryshme të pagesave për blerjet on-line;
- të përdorë valutat në veprimet tregtare;
- të kryejë llogaritje me kursin e këmbimit për veprimet në valuta;
- të kryejë pagesa për blerjet on-line, duke zbatuar të gjitha procedurat e sigurisë;
- të zbatojë teknologjitë e reja për të arritur një komunikim të suksesshëm.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 5 Nxënësi kryen veprimet për hyrjen e mallrave në magazinë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë kontrollin fizik të mallrave;
- të kryejë kontrollin e dokumenteve shoqëruese të mallrave;
- të kryejë regjistrimin e hyrjeve të mallrave në magazinë;
- të kryejë regjistrimin e hyrjeve të mallrave në kartela;
- të plotësojë dokumentet për mallrat përkatës;
- të hartojë procesverbalin në rast të diferencave sasiore dhe cilësore të mallrave;
- të identifikojë mallrat e dëmtuar;
- të kryejë regjistrimin e mallrave të dëmtuar;
- të përdorë programin kompjuterik për regjistrimin e mallrave që hyjnë në magazinë;
- të sistemojë mallrat që hyjnë në magazinë;
- të sistemojë produktet, në varësi të kushteve të ruajtjes dhe kategorisë së produktit;
- të hartojë planin e qarkullimit dhe trajtimit të produkteve;
- të përcjellë në kohë dokumentet e magazinës në zyrën e kontabilitetit;

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik;
- të zbatojë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e zyrës mësimore apo mjedise reale pune.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet e dokumenteve dhe formularëve të marrë nga praktika e ndërmarrjeve ekonomike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të krahasuar oferta, kryer dhe regjistruar porosi, kryer blerjet, dokumentimin dhe regjistrimet përkatëse.
- Nxënësit duhet të përdorin Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për të kërkuar informacione në treg, krahasuar oferta, kryer dhe regjistruar porosi, kryer blerjet, dokumentimin dhe regjistrimet përkatëse.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së ambientit dhe pajisjeve të njësisë tregtare.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjediset e zyrës mësimore apo mjedise reale pune.
 - Materiale kancelarie.
 - Dokumente të ndryshme korrespondence model nga ndërmarrjet reale dhe të përgatitura nga mësuesi.
 - Formularë, dëftesa lëvrimi, fatura, regjistra të blerjeve të marra nga praktika ose përpunuar në modulet e mëparshme.
 - Kompjuter i lidhur me internetin.
-

3. Moduli “Veprime të shitjes”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	VEPRIME TË SHITJES	M-17-1266-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer procedurat e shitjes, për të dokumentuar dhe regjistruar shitjet në kushtet e një tregu kombëtar dhe ndërkombëtar.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në drejtimin mësimor “Ekonomi - Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi vendos marrëdhënie me klientët. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të kërkojë me kujdes informacione për klientët potencialë;- të kërkojë, në mënyrë të orientuar nga qëllimi, informacione mbi klientët në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar,- të identifikojë klientë potencialë të ndërmarrjes tregtare;- të hartojë lista të qarta dhe të plota të klientëve potencialë të evidentuar nga kërkimi, si dhe kontaktet me to;- të shqyrtojë dhe përditësojë kartelat e klientëve;- të përcaktojë mënyrën e hartimit të statistikave të sakta për shitjet që do të realizohen;- të mbajë dhe përditësojë periodikisht, një bazë të dhënash elektronike me informacione të detajuara, mbi marrëdhëniet me klientët realë dhe potencialë (mallrat dhe shërbimet që do të shiten, kushtet e lëvrimit dhe pagesave etj);- të përpunojë kërkesat e klientëve;- të hartojë lista të sakta dhe të plota përmbledhëse me informacione për klientët dhe karakteristikat e veprimeve me ta;- të hartojë lista të sakta të klientëve të preferuar dhe format e trajtimit të veçantë të tyre.- të përgatisë materialet informative që do t’u dërgohen klientëve potencialë, në bashkëpunim me sektorin e marketingut;- të postojë dhe dërgojë e-mail ndërmarrjeve të ndryshme, për t’i informuar dhe shfaqur interes për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit;	

- të përpunojë saktë përgjigjet e marra nga ndërmarrjet, duke veçuar ato ndërmarrje, të cilat shfaqin interes dhe mund të jenë klientë në të ardhmen;
- të hartojë lista të plota të ndërmarrjeve, me të cilat parashikohet të vazhdohen marrëdhëniet e biznesit;
- të parashikojë në bashkëpunim me sektorin e marketingut nxitësit e shitjes për këta klientë.
- të llogarisë shpenzimet e lidhura me shitjen (kosto, transport, garanci, montim, mirëmbajtje);
- të llogarisë çmimet e produkteve për njësi;
- të hartojë listat e çmimeve për klientët;
- të hartojë oferta të ndryshme;
- të zbatojë strategjitë e organizatës për krijimin e ofertave;
- të dërgojë informacione të plota, lista çmimesh dhe katalogë ndërmarrjesh, të cilat kanë shfaqur interes për bashkëpunim;
- të dërgojë oferta të veçanta dhe dhurata të ndryshme;
- të informojë saktë dhe në vazhdimësi klientët mbi të gjitha risitë në produkte dhe veprimtari;
- të zbatojë me rigorozitet rregullat ndërkombëtare të korrespondencës zyrtare me jashtë vendit dhe në gjuhë të huaj;
- të përzgjedhë dhe përdorë siç duhet gjuhën e huaj, me të cilën do të punohet;
- të përdorë fjalorin e duhur në komunikimin zyrtar;
- të hartojë letra zyrtare, me përmbajtjen e duhur dhe formulime të sakta, në marrëdhëniet me jashtë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 2 Nxënësi kryen procedurën e shitjes.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të grumbullojë dokumentacionin e nevojshëm për hartimin e ofertës, si gjendjen nga magazina, listën e çmimeve etj.
- të listojë saktë specifikimet e produktit të ofruar;
- të vendosë në mënyrën e duhur, kushtet dhe afatet e lëvrimit të mallit/mallrave në ofertë;
- të kryejë rishikimin dhe kontrollin e dokumentit të hartuar për verifikimin e gabimeve të mundshme përmbajtësore, gramatikore, të formatimit etj;
- të përdorë modelet e gatshme (templates) të ofruara;
- të zbatojë rregullat e drejtshkrimit dhe formatimit;
- të përgatisë materialet informative që do t'u dërgohen klientëve potencialë, në bashkëpunim me sektorin e marketingut;
- të hartojë kontrata shitblerjeje me klientë vendas dhe të huaj;
- të përpunojë kërkesat e klientëve;
- të pranohet, kontrollojë dhe regjistrojë saktë, porositë e

- mbërritura nga klientët;
- të llogarisë saktë shpenzimet e tjera që lidhen me realizimin e procesit të shitjes.
- të kontrollojë gjendjen e mallrave;
- të hartojë saktë njoftimet për plotësimin e gjendjeve të mallrave;
- të hartojë saktë dëftesat e lëvrimit dhe fletëdaljet e mallrave të shitur;
- të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për eksport, duke respektuar aftatet;
- të aplikojë skonto dhe rabate të kontraktuara me klientët;
- të hartojë saktë dokumentet shoqëruese të mallrave gjatë transportit;
- të kryejë kontrollin e gjendjes fizike të produkteve për shitje;
- të kontrollojë cilësinë e produktit, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- të verifikojë datat e skadencës së produktit;
- të përgatisë produktin për shpërndarje;
- të ambalazhojë produktin, sipas rastit;
- të përzgjedhë kushtet e lëvrimit dhe pagesës që i përshtaten më mirë ndërmarrjes tregtare, qëllimeve dhe kushteve të veprimtarisë së saj;
- të hartojë saktë faturat e shitjes së mallrave;
- të identifikojë forma të ndryshme të arkëtimeve (çek, kartë krediti, para në dorë etj);
- të kryejë arkëtime me çek, kartë krediti, para në dorë etj, duke zbatuar të gjitha procedurat e sigurisë;
- të përdorë valutat në veprimet tregtare;
- të kryejë llogaritje me kursin e këmbimit për veprimet në valuta;
- të pranojë pagesa dhe transferta on-line;
- të kryejë procedurat e inventarizimit të arkës dhe plotësimin e dokumenteve përkatëse;
- të kryejë kuadrinin ditor të arkës;
- të regjistrojë saktë ekzekutimin e porosive të klientëve;
- të pasqyrojë veprimet e klientëve në kartelat e tyre personale;
- të hartojë refuzimet e shitjeve për arsye dhe në situata të ndryshme;
- të përcjellë në kohë në zyrën e kontabilitetit, dokumentet e shitjes për ndjekjen e arkëtimeve;
- të hartojë procesverbalet, sipas rastit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 3 Nxënësi kryen shitje on-line.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndjekë hapat për të hyrë në faqen e web të ndërmarrjeve të ndryshme;
- të kontrollojë rubrikën e porosive të ardhura në web-in e ndërmarrjes tregtare, si dhe identifikojë saktë dhe qartë porositë e reja që duhet të përpunohen;
- të regjistrojë saktë porositë në regjistrin e tyre, duke bërë shënimet e duhura për të evidentuar origjinën e porosisë;
- të dërgojë në formë elektronike konfirmimin për marrjen e porosisë;
- të ruajë porosinë në formën e përshtatshme dhe të posaçme elektronike, për t'a përdorur për qëllime të mëtejshme.
- të identifikojë forma të ndryshme të arkëtimeve për shitjet on-line;
- të përdorë valutat në veprimet tregtare;
- të kryejë llogaritje me kursin e këmbimit për veprimet në valuta;
- të pranojë arkëtime për shitjet on-line, duke zbatuar të gjitha procedurat e sigurisë;
- të zbatojë teknologjitë e reja, për të arritur një komunikim të suksesshëm.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 4 Nxënësi kryen veprimet për daljen e mallrave nga magazina.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë saktë porosinë;
- të kryejë përpunime të thjeshta të mallrave në magazinë për t'i përshtatur për shitje.
- të përgatisë mallrat për dalje nga magazina;
- të kryejë kontrollin fizik të mallrave, gjatë daljes nga magazina;
- të hartojë fletëdaljen e mallrave nga magazina;
- të hartojë dokumentet shoqëruese të mallrave gjatë transportit;
- të kontrollojë dokumentet shoqëruese të mallrave;
- të kryejë regjistrimin e daljeve të mallrave nga magazina;
- të regjistrojë daljen e mallrave në kartela;
- të regjistrojë çmimin dalës të mallrave në kartela;
- të pasqyrojë zbatimin e porosisë;
- të përdorë programin kompjuterik për regjistrimin e mallrave që dalin nga magazina;
- të përcjellë në kohë dokumentet e magazinës në zyrën e kontabilitetit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës;
- të zbatojë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- të zbatojë shenjat konvencionale për sigurinë e produktit;

- të zbatojë rregullat dhe standardet e asgjësimit të produkteve të skaduara apo të prishura;
- të zbatojë procedurat për evidentimin dhe trajtimin e mallrave të skaduar;
- të respektojë informacionin e dhënë në etiketa;
- të respektojë të drejtat e konsumatorit për sigurinë e produktit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 5 Nxënësi përpunon ankesat e klientëve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë procedurat e sakta të pranimit të ankesave të klientëve, për ulje çmimesh dhe kthime mallrash;
- të kontrollojë me kujdes ankesat, nga pikëpamja formale dhe e përmbajtjes, si dhe të verifikojë vërtetësinë e tyre;
- të zgjidhë ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët, duke përdorur teknikat e duhura të komunikimit;
- të hartojë dokumente të sakta përcjellëse, si dhe të përgatisë kthimet mbrapsht të ankesave të pabazuara;
- të hartojë shkresën përcjellëse të motivuar saktë për zyrën e kontabilitetit për uljet e çmimeve të pranuar;
- të hartojë saktë dokumentet e marrjes në dorëzim dhe hyrjes së mallrave të kthyera në magazinë;
- të kryejë procedurat e plota të kontrollit të dokumenteve të mallrave të kthyera dhe të pranimit të tyre;
- të regjistrojë saktë, në kartelat e klientëve, dokumentet e mallrave të kthyera, uljet e çmimeve dhe arsyet përkatëse;
- të përcjellë në kohë në zyrën e kontabilitetit dokumentet e mallrave të kthyera.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e zyrës mësimore apo mjedise reale pune.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet e dokumenteve dhe formularëve të marrë nga praktika e ndërmarrjeve ekonomike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të ruajtur dhe motivuar klientët aktualë dhe siguruar klientë të rinj, hartuar kontrata shitblerjeje, kryer shitjet, dokumentuar dhe regjistruar ato.
- Nxënësit duhet të përdorin Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i

shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për kërkimin, vendosjen dhe ruajtjen e marrëdhënieve me klientët dhe kryerjen e shitjeve.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së ambientit dhe pajisjeve të njësisë tregtare.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjediset e zyrës mësimore apo mjedise reale pune.
 - Materiale kancelarie.
 - Dokumente të ndryshme korrespondence model nga ndërmarrjet reale dhe të përgatitura nga mësuesi.
 - Formularë, dëftesa lëvrimi, fatura, regjistra të shitjeve të marra nga praktika ose përpunuar në modulet e mëparshme.
 - Kompjuter i lidhur me internetin.
-

4. Moduli “Prezantimi në panairë”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PREZANTIMI NË PANAIRE	M-17-1267-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i përgatit nxënësit të kryejnë veprimet e përgatitjes së stendave, të materialeve të shkruara, të reklamës dhe promocionit për panairët në të cilat merr pjesë, të kryejë veprimet dhe bisedat e shitjes në panair, si dhe veprimet e nevojshme pas panairit.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në drejtimin mësimor “Ekonomi - Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përgatitet për të marrë pjesë në panair. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përcaktojë qartë mesazhin që do të përcillet në panair nga ndërmarrja tregtare, në lidhje me veprimtarinë dhe identitetin e saj;- të hartojë sloganin i cili të shprehë saktë, qartë dhe në mënyrë të koncentruar, mesazhin e përcaktuar për ndërmarrjen tregtare, produktin apo imazhin e saj në këtë prezantim;- të hartojë lista të sakta dhe të plota të detyrave që duhet të kryhen për përgatitjen e ndërmarrjes tregtare për panair;- të kryejë qartë ndarjen e detyrave, duke përcaktuar e afatet kohore të realizimit të tyre dhe caktimin e përgjegjësiive përkatëse për përgatitjen për panair;- të hartojë lista të plota të materialeve që duhen për realizimin e panairit, ku të evidentojë qartë për secilin burimin nga do të sigurohet;- të përcaktojë qartë materialet që do të sigurohen nga vetë ndërmarrja tregtare dhe ato që do të porositen tek organizatorët e panairit;- të llogarisë kostot e pjesëmarrjes në panair, duke parashikuar mënyrën e mbulimit të tyre;- të përcaktojë mënyrën dhe kohën e saktë të transportimit të materialeve për në panair;- të marrë masa për sigurimin e financimit në panair;- të aplikojë për pjesëmarrje në panair, duke hartuar saktë kërkesën për pjesëmarrje dhe dërgimin e saj tek	

organizatorët e panairit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 2 Nxënësi realizon standën e panairit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë mënyrën se si do të përcillet nga stenda mesazhi i mishëruar në slogan (me anë të ngjyrave, pamjeve, figurave apo materialeve tredimensionalë, në mënyrë statike apo dinamike etj);
- të përcaktojë saktë ngjyrat, skemën, materialet, pajisjet e standës;
- të identifikojë elementët që ndikojnë në tërheqjen e konsumatorëve;
- të përzgjedhë mënyrat dhe mjetet e ekspozimit të mallrave dhe shërbimeve;
- të bëjë ndarjen e detyrave për përpunimin e pjesëve përbërëse të standës (materialet në kompjuter, printimin etj);
- të identifikojë bashkëpunëtorët sipas rolit të tyre në veprimtarinë profesionale;
- të japë dhe marrë udhëzime me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës, duke përdorur terminologji të qartë në komunikim;
- të vendosin kontakte me ndërmarrjet për sigurimin e produkteve që do të paraqiten, si dhe përfshirjen në paraqitje të firmës mbështetëse;
- të përcaktojë saktë dhe qartë përmbajtjen, strukturën dhe paraqitjen e prezantimeve elektronike dhe audiovizive që do të prezantohen në panair;
- të përcaktojë mënyrën e veshjes në panair në sintoni me sloganin, veprimtarinë e ndërmarrjes tregtare dhe mesazhin që kërkohet të përcillet;
- të sigurojë në kohë materialet e nevojshme për montimin e standës dhe veshjet e caktuara;
- të përpunojë katalogun e panairit, duke respektuar rregullat mbi elementet e domosdoshëm të tij;
- të hartojë fletëpalosje dhe materiale të tjera reklamuese, informuese në sintoni me mesazhin që do të përcillet, ngjyrat dhe sloganin e panairit;
- të hartojë oferta speciale, të qarta dhe të sakta, për panairin;
- të hartojë kartvizita dhe materiale të tjera informative për ndërmarrjen tregtare ose personelin e saj;
- të printojë dhe përgatisë materialet e hartuara në formën e duhur;
- të përgatisë për transport materialet e hartuara, duke i paketuar mirë ato, për mënjanimin e dëmtimeve gjatë transportit;

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 3 Nxënësi prezanton ndërmarrjen tregtare në panair.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të njihet me rregullat e panairit;
- të respektojë sinjalistikën në mjedisin e punës;
- të zbatojë rregullat përkatëse të panairit;
- të zbatojë parimet bazë të komunikimit;
- të zbatojë parimet e punës në grup;
- të kryejë procedurën e plotë të marrjes në dorëzim të materialeve të porositura dhe të kartave të kreditit për blerjet me para në dorë dhe nga vizitorët;
- të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- të montojë stendën, sipas ndarjes së parashikuar të detyrave;
- të kryejë përgatitjet e nevojshme për vendosjen e prezantimeve elektronike dhe provën e tyre;
- të sistemojë produktet në përputhje me qëllimin e aktivitetit sipas procedurave përkatëse.
- të mirëpresë klientin në stendën e panairit;
- të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- të përcjellë tek konsumatori imazhin e njësisë tregtare;
- të kryejë saktë promocionin e ndërmarrjes tregtare dhe produktit në stendën e saj dhe në stendat e ndërmarrjeve të tjera gjatë panairit;
- të kryejë saktë promocionin dhe reklamimin e ndërmarrjes tregtare dhe produktit, gjatë panairit, me anë të prezantimeve elektronike ose audiovizuale duke zbatuar rregullat mbi formën, zërin etj;
- të kryejë saktë promocionin dhe reklamimin e ndërmarrjes tregtare dhe produktit, nëpërmjet shpërndarjes së dhuratave, në mënyrë sa më efektive gjatë panairit;
- të promovojë përfitimet që konsumatori merr nga produkti;
- të hartojë kontrata të plota dhe të sakta shit-blerjeje me firmat pjesëmarrëse në panair për periudha të ardhme;
- të kryejë blerje, duke respektuar procedurën dhe plotësuar dokumentet e duhura;
- të kryejë shitje, duke respektuar procedurën, sipas rastit (arkëtim të mëvonshëm, skonto për panairin, mënyra të ndryshe pagese etj);
- të marketojë produktin sipas politikave të ndërmarrjes;
- të përcaktojë veçoritë e produktit dhe ciklit të jetës së tij;
- të mbikëqyrë pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës;
- të zbatojë parimet e mjedisit të qëndrueshëm.

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 4 Nxënësi zhvillon panairin on-line.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të planifikojë pjesëmarrjen në panairin on-line;
- të identifikojë nëpërmjet hulumtimit në internet, platformën e organizimit të panairit on-line;
- të identifikojë panairin on-line, si vend takimi, ku takohen dy grupet e interesave, konsumatori virtual dhe biznesi fiziko-online;
- të njihet me procedurat dhe rregullat e pjesëmarrjes së panairit on-line;
- të identifikojë avantazhet dhe disavantazhet e panairit on-line nga ai fizik;
- të zbatojë teknologjitë e reja për të arritur një komunikim të suksesshëm në prezantimin e panairit on-line;
- të sigurojë materialet dixhitale për foto-galerinë e prezantimit në mënyrë profesionale në platformën e panairit on-line;
- të sigurojë materialet dixhitale për video-reklama e prezantimit në mënyrë profesionale në platformën e panairit on-line;
- të sigurojë materialet dixhitale për kartëvizitat virtuale të prezantimit në mënyrë profesionale në platformën e panairit on-line;
- të përdorë terminologji profesionale në gjuhë amtare dhe të huaj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 5 Nxënësi kryen veprimet pas panairit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë faturën e saktë përmbledhëse të shitjeve të panairit me karta krediti dhe debiti;
- të kuadrojë faturën e saktë përmbledhëse të shitjeve në panair me karta krediti dhe debiti;
- të kryejë regjistrimet e sakta dhe të plota të shitjeve/blerjeve të panairit, në regjistrat përkatës dhe kartelat e magazinës;
- të kuadrojë kartelat e magazinës;
- të kryejë porositë në ndërmarrjet e tjera, duke llogaritur saktë sasisë eventuale të të mirave që do të porositen për të plotësuar gjendjet e magazinës;
- të kryejë saktë procedurat e marrjes në dorëzim dhe dokumentimit të mallrave të porositura;
- të plotësojë saktë urdhërpagesën për blerjet e kryera me pagesë të mëvonshme;
- të regjistrojë arkëtimet nga shitjet me pagesë të menjëhershme dhe të mëvonshme;
- të llogarisë saktë rezultatin ekonomik të panairit;
- të hartojë statistika të sakta, të plota dhe domethënëse mbi veprimet e panairit;
- të analizojë shitjet, sipas mallrave/grupmallrave dhe evidentojë mallrat më të shitura, mallrat që kërkojnë ndryshime në çmime etj;
- të kryejë analiza krahasuese me vitet e kaluara për shitjet e panairit, duke interpretuar saktë statistikat e hartuara;
- të raportojë te eprorët në lidhje me veprimtarinë e kryer.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e zyrave mësimore ose praktikave në biznes.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të realizimit të mënyrave promovuese të panairove dhe panairove on-line.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përgatitjen e standave, të materialeve të shkruara, të reklamës dhe promocionit, për kryejn e veprimeve dhe bisedave të shitjes në panair, si dhe veprimeve të nevojshme pas panairit.
- Nxënësit duhet të përdorin Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Për të munduruar realizimin e modulit, mund të organizohen disa kohë më parë, kur është e mundur, edhe vizita në panairove dhe pjesëmarrje si klientë në panairove On-line.

-
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
 - Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së ambientit dhe pajisjeve të njësive tregtare.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjediset e zyrave mësimore apo mjedise reale pune.
 - Materiale kancelarie.
 - Materiale të prezantimit në panairë të ndërmarrjeve reale tregtare.
 - Kompjuter.
 - Materiale të ndryshme audiovizuale, foto, filma që ilustrojnë paraqitje në panairë.
Kompjuterat me programe të përpunimeve grafike dhe me lidhje në Internet.
-

5. Moduli “Llogaritja dhe kontabilizimi në ndërmarrjen tregtare”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	LLOGARITJA DHE KONTABILIZIMI NË NDËRMARRJEN TREGTARE	M-17-1271-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për kontabilizimin e shitjeve, blerjeve e kostove, për regjistrimet kontabël në rastin e kthimeve të mallrave të blera e të shitura, si dhe për kryerjen e veprimeve me tatimin mbi fitimin (TF) dhe llogaritjen e dokumentimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), në një ndërmarrje tregtare.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në drejtimin mësimor “Ekonomi-Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi kontabilizon shitjet, blerjet dhe kostot në ndërmarrjen tregtare.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të çelë saktë ditarin analitik të shitjeve;- të regjistrojë saktë faturat e shitjes në librin e shitjeve të kryera, duke respektuar normativat tatimore përkatëse;- të kontabilizojë saktë daljen e mallrave nga magazina;- të kontabilizojë shitjet dhe marrëdhëniet përkatëse me klientët në partitarët e tyre;- të regjistrojë saktë faturat e emetuara në regjistrin e tyre në funksion të ndjekjes së afateve;- të çelë ditarin analitik të blerjeve, duke respektuar normativat ligjore në fuqi;- të regjistrojë saktë blerjen e mallrave apo shërbimeve në ditarin analitik të blerjeve;- të kryejë regjistrimin e saktë kontabël të rritjes së gjendjes së magazinës në sajë të blerjeve;- të kontabilizojë saktë blerjet në partitarin e furnitorëve;- të regjistrojë saktë faturat në regjistrin e faturave të marra dhe kontrollojë afatet e skadencës së pagesës së tyre;- të identifikojë dhe kontabilizojë saktë kostot në ndërmarrjen tregtare;- të zbatojë bazën ligjore në mbajtjen e kontabilitetit në shoqëritë tregtare;- të ndajë të drejtat nga detyrimet në ndërmarrjet tregtare. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p>	

-
- Vëzhgim me listë kontrolli.
 - Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 2 Nxënësi kryen regjistrimet kontabël në rastin e kthimeve të mallrave të blera e të shitura.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë saktë regjistrimet kontabël të kthimeve të mallrave të shitura;
- të kryejë saktë regjistrimet kontabël të kthimeve të mallrave të blera;
- të kontabilizojë saktë uljet e çmimeve të mallrave të shitura;
- të kontabilizojë saktë uljet e çmimeve të mallrave të blera;
- të kryejë saktë regjistrimet kontabël të mallrave që do të kthehen, në llogaritë jashtë bilancit, të mbajtura përkohësisht në ruajtje në magazinë;
- të zbatojë bazën ligjore në mbajtjen e kontabilitetit në shoqëritë tregtare;
- të ndajë të drejtat nga detyrimet në ndërmarrjet tregtare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN3 Nxënësi kryen llogaritjen dhe dokumentimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të llogarisë saktë qarkullimin vjetor për të konstatuar në se është ose jo subjekt i TVSH;
- të llogarisë, duke respektuar normativat ligjore në fuqi, qarkullimin vjetor në rastin e ndërprerjeve të veprimtarisë së njësisë tregtare;
- të aplikojë për regjistrimin për TVSH, nëse ndërmarrja tregtare është subjekt i saj, duke plotësuar saktë dokumentacionin e nevojshëm;
- të kryejë regjistrimin, në rast se ndërmarrja tregtare ka ndryshim të vëllimit të veprimtarisë, duke hartuar saktë dokumentet e duhura;
- të kryejë saktë procedurën e aplikimit për ç`regjistrim;
- të përpunojë njoftimet e organeve tatimore mbi rivlerësimin e TVSH;
- të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për eksport;
- të regjistrojë saktë faturat e eksporteve, në librin e shitjeve;
- të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për import, duke respektuar afatet;
- të llogarisë saktë vlerën e tatueshme për faturat e importit;
- të llogarisë saktë TVSH për importet;
- të kryejë saktë regjistrimet e faturave të importit në librin e blerjeve, duke regjistruar dhe TVSH përkatëse;

- të regjistrojë saktë faturat e të gjitha blerjeve dhe shitjeve të kryera, në librat e blerjeve dhe shitjeve;
- të përgatisë dhe të deklarojë on-line librat e shitjes dhe blerjes, duke respektuar afatet e legjislacionit në fuqi;
- të plotësojë deklarata të sakta dhe të plota tatimore për TVSH;
- të kuadrojë shumat e deklaruara me ato të librave të shitjes dhe blerjes të deklaruara on-line, si dhe me regjistrat kontabël;
- të kryejë veprimet për derdhjen e TVSH;
- të regjistrojë shumat e njoftuara nga organet tatimore për rivlerësim të TVSH;
- të kuadrojë në fund të periudhës ushtrimore me zyrën e tatimeve për TVSH dhe të regjistrojë diferencat eventuale;
- të kryejë veprimet e duhura për rregullimin e diferencave me zyrën e tatimeve dhe shlyerjen e tyre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 4 Nxënësi kryen veprimet me tatimin mbi fitimin (TF).

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të parashikojë saktë fitimin e parashikuar për periudhën e ardhshme, duke u bazuar në periudhat e kaluara/planin e biznesit dhe ndryshimet e parashikuara të kushteve ose veprimtarisë;
- të ndjekë me rigorozitet procedurat e deklarimit të TF të parashikuar;
- të llogarisë saktë kuotat mujore të TF që do të paguhet në formë paradhënie gjatë periudhës së ardhshme, duke u bazuar në njoftimin e zyrës së tatimeve;
- të kryejë pagesat e TF, për shumën e saktë të llogaritur në afatin e duhur;
- të kontabilizojë saktë paradhëniet mujore nga TF;
- të llogarisë saktë fitimin faktik të ndërmarrjes tregtare në fund të periudhës ushtrimore;
- të llogarisë saktë shumat e TF që ndërmarrja duhet të derdhë ende ose të marrë nga shteti;
- të pasqyrojë saktë dhe qartë marrëdhënien me shtetin për TF, në bilancin e periudhës ushtrimore;
- të kryejë veprimet e plota dhe të sakta për të rregulluar marrëdhënien përfundimtare me shtetin për TF;
- të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- të zbatojë kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale, në komunikimin me eprorët dhe kolegët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e zyrave mësimore ose praktikant në biznes.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet e dokumenteve dhe formularëve të marrë nga praktika e ndërmarrjeve tregtare.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve që janë objekt i modulit.
- Nxënësit duhet të përdorin Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për të llogaritur TVSH, dhe TF dhe kryer veprimet për regjistrimin e tyre, deklaruar TVSH dhe TF, rregulluar marrëdhëniet me shtetin për to dhe kryer regjistrimet përkatëse kontabël.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së ambientit dhe pajisjeve në ndërmarrjet tregtare.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjediset e zyrave mësimore apo mjedise reale pune.
 - Materiale kancelarie.
 - Dokumente të ndryshme dhe formularë e regjistra kontabël model nga ndërmarrjet reale dhe të përgatitura nga mësuesi.
 - Materiale të ndryshme informative të marra nga web-i i faqes së sistemit tatimor mbi procedurat e shlyerjes së detyrimeve.
 - Kompjuter.
-

6. “Komunikimi dhe zgjidhja e problemeve”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Llogari
Niveli : IV I KSHK
Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodit	KOMUNIKIMI DHE ZGJIDHJA E PROBLEMEVE	M-17-1984-23
Qëllimi i modulit	Një modul praktik, që i pajis nxënësit me aftësi praktike, në lidhje me koncepte të rëndësishme si komunikimi me eprorët dhe kolegët, identifikimi i problematikave në vendin e punës, si dhe zgjidhja e problemeve profesionale.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12-të, në profilin mësimor “Tregti”, Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi komunikon me eprorët dhe kolegët. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të identifikojë aftësitë e duhura, si çelësi i komunikimit të efektshëm në ndërmarrje;- të ndërtojë kanalet e komunikimit;- të adresojë drejt dhe saktë problematikat;- të zhvillojë aftësinë e përshtatjes, gjatë komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm;- të përcaktojë aftësitë që influencojnë sjelljen e individit në marrëdhëniet e punës;- të zbatojë rregullat e komunikimit me eprorët, duke përdorur inteligjencën emocionale;- të zbatojë rregullat e komunikimit me kolegët, duke përdorur inteligjencën emocionale;- të zbatojë standardet e sjelljes profesionale, gjatë komunikimit;- të zbatojë rregullat e higjienës, gjatë komunikimit me eprorët dhe kolegët; <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Demonstrim.- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RN 2 Nxënësi identifikon problematikat në vendin e punës, si dhe aftësitë për zgjidhjen e tij. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p>	

- të indentifikojë llojin e problemit që ka hasur në vendin e punës;
- të grumbullojë informacionin e nevojshëm në lidhje me problematikat;
- të përpunojë informacionin e grumbulluar;
- të përcjellë informacionin në mënyrë efektive;
- të bashkëpunojë me kolegët për zgjidhjen e problemit;
- të menaxhojë emocionet;
- të demonstrojë etikë, gjatë trajtimit të problemit në vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Demonstrim.
- Kontrolli i dosjes personale e nxënësit.

RN 3 Nxënësi zgjidh problemet në mjedisin e punës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vlerësojë aspektin kulturor të problemit;
- të përcaktojë dukuritë që e shoqërojnë problemin;
- të përcaktojë rëndësinë e problemit;
- të përcaktojë rolin e secilit prej faktorëve që kanë shkaktuar problemin;
- të përzgjedhë mënyrën e duhur për trajtimin e problemit;
- të kryejë një analizë konstruktive;
- të ofrojë zgjidhje intuitive dhe ide në varësi të problemit;
- të transmetojë energji pozitive;
- të bashkëpunojë në gjetjen e zgjidhjeve të problemeve, duke mirëpritur çdo këshillë dhe kritikë si një shtysë për të përmirësuar performancën personale dhe të grupit të punës;
- të argumentojë në forma të ndryshme (me gojë, me shkrim) qëndrimin e vet për problemin e identifikuar;
- të prezantojë qëndrimin e tij/saj, duke përdorur drejt gjuhën e shprehur ose të shkruar;
- të ndërmjetësojë mes palëve, duke përdorur teknikat e duhura të komunikimit;
- të përdorë instrumentet ligjorë, kombëtare dhe ndërkombëtare, që kanë në fokus zgjidhjen e problematikave të ndryshme në punë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Demonstrim.
- Kontrolli i dosjes personale e nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjedise reale të punës në biznes/ zyrave mësimore.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të vërë në dispozicion të nxënësve legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë të punonjësve dhe të parandalimit, mbrojtjes, neutralizimit dhe shpëtimit ndaj fatkeqësive

natyrore, zjarrit etj, si dhe evakuimit të punonjësve.

- Nxënësit duhet të përdorin Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, si komunikimi me eprorët dhe kolegët, identifikimi i problematikave në vendin e punës, si dhe zgjidhja e problemeve profesionale.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së ambientit dhe pajisjeve të zyrës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Standardet ndërkombëtare të punës (konventat).
 - Kuadri shqiptar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në punë.
 - Kodi i punës.
 - Kodi etik.
 - Rregullore të brendshme.
 - Kompjuter.
-

7. Moduli “Kujdesi ndaj klientit në ndërmarrjen tregtare”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV i KSHK
Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	KUJDESI NDAJ KLIENTIT NË NDËRMARRJEN TREGTARE	M-17-1270-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të zbatuar procedurat e pritjes dhe përcjelljes së klientit në ndërmarrjen tregtare, si dhe pranon kërkesa, zgjidh ankesa të klientit, duke patur parasysh se klientët janë personat më të rëndësishëm për çdo sipërmarrje.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12-të, në profilin mësimor “Tregti”, Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi mirëpret dhe informon klientin. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të mirëpresë klientin në njësinë e shitjes/ndërmarrjen tregtare;- të akomodojë klientin në mënyrën e duhur;- të krijojë klimë pozitive për klientin, për t`a mbajtur atë sa më gjatë në njësinë e tij;- të trajtojë drejt çdo klient në mënyrë individuale;- të kryejë shoqërimin e klientit në sektorë të ndryshëm të njësisë së shitjes;- të prezantojë produktin e kërkuar në treg;- të informojë klientin mbi njësinë dhe produktin e kërkuar, në kohën dhe mënyrën e përshtatshme;- të këshillojë klientin për produkte të tjera;- të përdorë me efektivitet mënyra të ndryshme komunikimi me klientët;- të krijojë klimë pozitive gjatë diskutimit me klientin;- të përdorë gjuhën e trupit gjatë komunikimit me klientin;- të përdorë drejt pyetjet në komunikim me klientin;- të dëgjojë me vëmendje klientin;- të zgjidhë kërkesat e klientit;- të plotësojë dëshirat e klientit;- të prezantojë ofertat për klientin, pasi i ka formuluar saktë dhe kuptueshëm ato;- të kryejë përcjelljen nga njësia e shitjes, duke e falenderuar dhe përhëndetur me mirësjellje klientin;- të bindë klientin, duke shprehur qartë dobitë dhe	

avantazhet e ofertave për të.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 2 Nxënësi pranon kërkesat dhe zgjidh ankesat e klientit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të pranojë vërejtjet dhe sugjerimet nga klientët për përmirësime të shërbimeve të shitjes;
- t'iu përgjigjet pozitivisht dhe me ndjeshmëri vërejtjeve, sugjerimeve dhe kërkesave të tyre;
- të dëgjojë me vëmendje klientin gjatë paraqitjes së ankesave;
- të pranojë ankesën nga klienti, duke kërkuar ndjesë;
- të zbatojë rregullat e sjelljes me klientin në rast ankesash;
- të përdorë gjuhën e trupit gjatë komunikimit me klientin;
- të përkujdeset për klientin, sipas rregullit në rast ankesash;
- të përkujdeset për klientin e inatosur, sipas rregullit;
- të zgjidhë ankesat e klientit në favor të dyanshëm;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 3 Nxënësi nxit dhe bind klientët për të kryer blerjen.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të udhëheqë drejt biseda të përditshme tregtare;
- të informojë klientët në mënyrë të saktë dhe të plotë me karakteristikat e produkteve dhe përparësitë e tyre;
- të përdorë me efektivitet teknika të ndryshme argumentimi;
- të nxisë klientin me anë të ofertave speciale, pa ushtruar presion mbi të;
- të përshtatet si duhet ndaj reagimit të klientëve;
- të trajtojë me efektivitet kundërshtimet e klientëve, duke përdorur teknikat e duhura;
- të negociojë me klientin;
- të udhëheqë drejt bisedat e shitjes me klientët me pretendime;
- të përdorë tonalitetin e zërit, mënyrën e të folurit, artikulimin për një komunikim efektiv;
- të interpretojë sinjalet e gjuhës së trupit të klientit gjatë komunikimit me të;
- të zbatojë teknikat e të dëgjuarit aktiv;
- të kryejë biseda sqaruese dhe argumentuese me klientët;
- të kryejë saktë procedurën e përfundimit të shitjeve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë punës për organizimin e vendeve të punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale të punës në biznes/zyrave mësimore.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur tema dhe situata nga praktika ekonomike shqiptare.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të kujdesit ndaj klientëve normal dhe atyre me aftësi ndryshe, dokumentimit të të dhënave të tyre, si dhe pranimin e kërkesave dhe trajtimit të ankesave të tyre në një ndërmarrje tregtare.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur për të zbatuar procedurat e pritjes dhe përcjelljes së klientit në ndërmarrjen tregtare, për të pranuar kërkesa, zgjidhur ankesa të klientit, për të komunikuar dhe udhëhequr bisedat me klientët duke i nxituar ata për blerje, duke patur parasysh se klientët janë personat më të rëndësishëm për çdo sipërmarrje. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë, si dhe të zbatojnë lojën me role për këto veprimtari.
- Nxënësit duhet të përdorin Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit, të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjediset e ndërmarrjeve të ndryshme tregtare.
 - Mjete klasike dhe bashkëkohore të komunikimit.
 - Materiale kancelarie.
 - Informacione të shkruara, ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme.
 - Kompjuter.
 - Lidhje interneti.
-

8. Moduli “Përdorimi i kasës fiskale dhe “POS” terminal”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV I KSHK
Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRDORIMI I KASËS FISKALE DHE “POS” TERMINAL	M-17-1707-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer procedurat e përdorimit të kasës fiskale dhe të “POS” terminale (sistem hardware për përpunimin e pagesave me karta, në vendet e shitjeve me pakicë) në ndërmarrjen tregtare.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12-të, në profilin mësimor “Tregti”, Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi përdor kasën fiskale për shitjen e produkteve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të ndezë kasën dhe kontrollojë letrën termike në kasës;- të kryejë shitje me artikuj pa çmime;- të kryejë shitje të artikujve me çmime të fiksuara;- të kryejë shitje të artikujve me çmime të ndryshuara;- të kryejë shitje me faturë TVSH-je;- të kryejë mbylljen ditore të kasës;- të kryejë transmetim manual;- të lexojë gjendjen e arkës;- të kryejë funksione të avancuara për artikujt e shitur;- të kryejë regjistrimin e artikujve të rinj;- të kryejë ndryshime në të dhënat e artikujve;- të zbatojë normativat ligjore mbi mbajtjen e kasës regjistruese. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit. <p>RN 2 Nxënësi përdor “POS” terminal, për pagesat me kartë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të ndezë “POS” për të pranuar pagesa;- të kryejë shitje duke përdorur POS;	

- të plotësojë shumën që duhet t`i mbajë klientit;
- t`i kërkojë klientit të vendosë kodin 4 shifror (pin), duke shtypur butonin Enter;
- t`i japë klientit kopjen e faturës;
- të mbajë kopjen e tregtarit me firmën e klientit për shumën e shpenzuar;
- të mbledhë të gjitha kopjet e tregtarit sipas radhës;
- të kryejë përmbydhjen e shitjeve të kryera në “POS” në fund të ditës;
- të kryejë shlyerjen vetëm në ato ditë që ka kryer transaksione në terminal;
- të ruajë kopjen e raportit të fundit të ditës nga terminali POS.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 3 Nxënësi kryen përpunimin e “Cash-it” në sportel /banak, sipas rregullave të sigurisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbajë vlerat në arkë, sipas udhëzimeve përkatëse;
- të vendosë në kasafortën ditore vlerat që nuk janë të nevojshme për shërbimin ndaj klientit;
- të verifikojë limitin e Cash-it në kasafortën ditore;
- të dorëzojë/depozitojë vlerat Cash me proceverbal.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale të punës në biznes/zyra mësimore.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të vërë në dispozicion të nxënësve sa më shumë të jetë e mundur teknologjinë e përdorur nga ndërmarrjet reale tregtare.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të mbikëqyrur dhe të pavarur për përdorimin e kasës fiskale dhe “POS”.
- Nxënësit duhet të përdorin Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e pagesave dhe verifikimeve të arkës.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së ambientit dhe pajisjeve, gjatë përdorimit të kasës fiskale dhe “POS” terminal, në ndërmarrjen tregtare.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjediset e ndërmarrjeve tregtare.
 - Kasë fiskale.
 - Aparate POS.
 - Kasafortë.
 - Informacione të shkruara ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme.
 - Kompjuter.
Lidhje Interneti.
-

9. Moduli “Hartimi i kontratave në ndërmarrjen tregtare”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV i KSHK
Klasa: 13

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HARTIMI I KONTRATAVE NË NDËRMARRJEN TREGTARE	M-17-1273-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të hartuar e plotësuar kontrata të llojeve të ndryshme në ndërmarrjen tregtare.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12-të, në profilin mësimor “Tregti”, Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi harton kontratat ekonomike. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të konstatojë diferencat në qarkullimin e mallrave;- të regjistrojë diferenca në qarkullimin e mallrave;- të identifikojë elementët e kontratave ekonomike;- të përpilojë kontratat e qarkullimit të mallrave;- të plotësojë kontrata ekonomike, sipas rregullave të posaçme për lidhjen e tyre, duke kryer para-bisedimet për lidhjen e kontratës. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RN 2 Nxënësi kryen përpilimin dhe plotësimin e kontratave të punës. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përcaktojë kushtet për lidhjen e kontratave të punës;- të përcaktojë efektet e kontratës së punës;- të përcaktojë rastet e anulimit të kontratës së punës;- të identifikojë saktë elementet e kontratës së punës;- të përpilojë një kontratë pune;- të plotësojë kontratën e punës, sipas kushteve të paracaktuara. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RN 3 Nxënësi realizon kontrata shitjeje dhe blerjeje. <i>Kriteret e vlerësimit:</i></p>	

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë elementet thelbësore të kontratës mbi shitjen dhe blerjen;
- të identifikojë objektin e kontratës mbi shitjen dhe blerjen;
- të llogarisë çmimin e kontratës mbi shitjen dhe blerjen;
- të caktojë në kontratë detyrimet e shitësit;
- të caktojë në kontratë detyrimet e blerësit;
- të identifikojë në kontratë vonesat e blerësit dhe shitësit;
- të identifikojë elementet e kontratës së shitjes dhe kontratës së blerjes;
- të përpilojë kontratën e shitjes dhe kontratën e blerjes;
- të plotësojë kontratën e shitjes dhe kontratën e blerjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen hartimin dhe plotësimin e kontratave të llojeve të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përpilojë kontratën mbi sigurimin;
- të plotësojë kontratën mbi sigurimin;
- të identifikojë llojet e sigurimit;
- të përcaktojë elementët e kontratës së sigurimit;
- të identifikojë policat e sigurimit;
- të përpilojë kontratën mbi shpërndarjen;
- të plotësojë kontratën mbi shpërndarjen;
- të përcaktojë elementët e kontratës së shpërndarjes;
- të përpilojë kontratën mbi transportimin e mallit;
- të plotësojë kontratën mbi transportimin e mallit;
- të identifikojë elementët e kontratës së transportit;
- të identifikojë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e ndërmarrjeve tregtare, si dhe në mjediset e zyrës mësimore.
- Lidhur me përmbajtjen e rezultateve mësimore, theksohet që moduli është i tillë që, shërben për t'u thelluar në argumente të ngjashme, të trajtuara në mënyrë më të thjeshtë në zyrën mësimore që zhvillohet në shkollë.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur dokumentet dhe shembujt konkretë për hartimin dhe plotësimin e kontratave të llojeve të ndryshme në ndërmarrjen tregtare.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të mbikëqyrur dhe të pavarur për hartimin dhe plotësimin e kontratave të llojeve të ndryshme në ndërmarrjen tregtare.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i

shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për dokumentimin dhe evidentimin e shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera të veprimtarisë.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjediset e ndërmarrjeve të ndryshme.
 - Template të llojeve të ndryshme kontratash të ndërmarrjeve tregtare.
 - Materiale kancelarie.
 - Informacione të shkruara ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme.
 - Kompjuter.
 - Lidhje Interneti.
-

10. Moduli “Procedurat në transportin e mallrave”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV I KSHK
Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PROCEDURAT NË TRANSPORTIN E MALLRAVE	M-17-1272-16
Qëllimi i modulit	Një modul praktik, që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer procedurat e transportit rrugor, hekurudhor, ujqor dhe ajror të mallrave.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12-të, në profilin mësimor “Tregti”, Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi ndjek procedurat në transportin rrugor të mallrave. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të marrë kërkesën nga klienti;- të analizojë gjerësisht kërkesën (të shohë emrin e firmës që dëshiron të transportojë mallin, llojin e mallit, llojin e paketimit, vendin ku gjendet malli dhe elemente të tjera të kërkesës);- të përpilojë dhe dërgojë ofertën në bazë të kërkesës së klientit e cila duhet të përmbajë (emrin, adresën dhe vendin e klientit ose të firmës që dëshiron të transportojë mallin);- të marrë aprovimin e ofertës nga klienti;- të lidhë kontratën me shkrim për transportin e mallit në destinacionin e kërkuar;- të kujdeset për të dërguar mjetin e transportit të duhur në vendin e ngarkimit të mallit;- të kujdeset dhe të përcjellë ngarkesën e mallit dhe marrjen e dokumenteve përcjellëse të mallit (listën e mallit, emrin e dërguesit të mallit, pikën e destinacionit, vendin ku duhet të dërgohet malli (emri i firmës adresa dhe vendi), numrin e ngarkesës, llojin e transportit, llojin e paketimit të mallit, peshën e mallit në kg, volumin e mallit në m³ etj);- të kujdeset dhe mbikqyrë transportimin e mallit në vendin e destinacionit dhe shkarkimin e tij;- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë punës. Instrumentet e vlerësimit:	

-
- Pyetje përgjigje me gojë.
 - Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi ndjek procedurat në transportin hekurudhor të mallrave.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë kërkesën nga klienti dhe t`a analizojë atë;
- të identifikojë kërkesën në librat përkatës në stacionin hekurudhor, ku është bërë kërkesa;
- t`i japë fletë ngarkesën klientit në pesë kopje;
- të plotësohet fletë ngarkesa nga klienti, pasi ai është sqaruar saktë për mënyrën se si duhet plotësuar brenda vijave të plota të fletë ngarkesës;
- të pranohet fletëngarkesa nga ekonomisti, i cili në bazë të shënimeve të klientit, bën llogaritjet e shpenzimeve të transportit;
- të ngarkohet malli në stacionin hekurudhor, duke treguar kujdes për ngarkimin e mallit përkatës;
- të dërgohet malli në vendin e destinacionit, duke treguar kujdes për mbërritjen në vendin e destinacionit;
- të ndjekë procedurën tek departamenti përkatës, i cili në bazë të fletëngarkesës, jep orarin e dërgimit të mallit ose ngarkesës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë punës.

RN 3 Nxënësi ndjek procedurat në transportin ujor të mallrave.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të pëshkruajë procedurat e mbërritjes së mjetit lundrues në porte (kohën e parashikuar të mbërritjes, tipin e mjetit lundrues, kombësinë, kapacitetin, portin e nisjes, portet ku ka ndaluar gjatë udhëtimit dhe një përshkrim të përgjithshëm të ngarkesës dhe pasagjerëve);
- të njoftohet autoriteti doganor nga drejtuesi i mjetit lundrues;
- të dorëzojë manifestin dhe listën e ekuipazhit;
- të procedojë për deklarat e lëshuara nga kapiteni, si deklaratë ngarkese, deklaratë për furnizime në anije, deklarata e ekuipazhit dhe lista e pasagjerëve;
- të ndjekë procedurat e ngarkimit të mjetit lundrues;
- të ndjekë procedurat e largimit të mjetit lundrues nga porti dhe territori doganor (njoftimi duhet të përmbajë informacion rreth kohës së parashikuar të largimit, portin e destinacionit dhe një përshkrim të përgjithshëm të ngarkesës së tij);
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 4 Nxënësi ndjek procedurat në transportin ajror të mallrave.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë kërkesën nga klienti dhe të përgatisë transportimin e produkteve për në aeroport;
- të konfirmojë dhe etiketojë produktet e marra nga klienti;
- të konfirmojë sasinë dhe cilësinë e mallrave;
- të plotësojë faturën dhe të transportojë mallin në magazinë;
- të pajisë me deklaratë eksporti klientin, duke përdorur sistemin e përpunimit të informacionit të doganave të transportit ajror;
- të presë aprovimin nga dogana, nëse nuk ka probleme me deklaratën;
- të ruajë mallin në magazinë (mallrat që marrin aprovim për eksport vendosen në një kantier për t'u ngarkuar në avion);
- të ngarkohet malli dhe të niset për tek linja ajrore përgjegjëse për transportimin në avionin;
- të njoftohet për mbërritjen e mallit në destinacion;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 5 Nxënësi përgatit dokumentin për zhdoganimin e mallit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të verifikojë arritjen e mallit të importuar në pikë kalimin kufitar;
- të kontrollojë dokumentet përcjellëse nga ana e sektorit të shpërndarjes;
- të paraqesë dokumentet origjinale dhe dokumentet e importuesit, përmes deklaratës doganore;
- të përshkruajë kontrollin fizik të mallrave (punonjësi doganor);
- të krahasojë deklarimin e mallit me dokumente dhe gjendjes faktike/fizike të mallit të paraqitur;
- të verifikojë përputhshmërinë e dokumenteve të paraqitura me gjendjen faktike;
- të nënshkruajë deklaratën doganore;
- të japë urdhërin për pagesën e taksës doganore nga sektori i shpërndarjes;
- të verifikojë nëse pagesa është dërguar në doganë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e firmës së speditonit.
- Rekomandohet që të hulumtohet në internet e sidomos në web-faqje të ndryshme botërore dhe në faqen e hekurudhës shqiptare <http://hsh.com.al/> dhe <http://www.dogana.gov.al/> <http://www.tirana-airport.com/business-to-business/cargo/> dhe faqe të tjera të rëndësishme.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të simuluar procedurat në organizimin e transportit të mallit nga një vend në një vend tjetër.
- Mësuesi duhet të ketë model të deklaratës doganore dhe dokumente të tjera të rëndësishme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për përcjelljen e procedurave të transportit të mallit dhe të njihen me punët e doganës, të speditonit dhe pagesat.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, të zbatohet demonstrimi praktik i aftësive të fituara.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjediset e firmave ushtrimore.
 - Materiale kancelarie.
 - Dokumente të përshtatsme të transportit rrugor, hekurudhor, ujqor dhe ajror të mallrave si, (lista e mallit, fletë ngarkesa për transportin rrugor, hekurudhor, ujqor dhe ajror të mallrave, oferta dhe kërkesa për llojet e transportit të mallrave).
Dokumente të tjera.
 - Përmbledhje legjislacioni në fushën e doganave etj.
 - Kompjuter.
-

11. “Zbatimi i rregullave për cilësinë, sigurinë dhe mjedisin”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV I KSHK
Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	ZBATIMI I RREGULLAVE PËR CILËSINË, SIGURINË DHE MJEDISIN	M-17-1988-23
Qëllimi i modulit	Një modul praktik, që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të siguruar cilësinë e mallrave dhe shërbimeve, duke ruajtur standardet e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12-të, në profilin mësimor “Tregti”, Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi zbaton standardin për sigurimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të kryejë kontrollin e cilësisë së produktit;- të zbatojë rregullat e higjienës;- të kryejë kontrollin e gjendjes fizike të produkteve për shitje;- të verifikojë datat e skadencës së produktit;- të zbatojë shenjat konvencionale për sigurinë e produktit;- të zbatojë rregullat dhe standardet e asgjësimit të produkteve të skaduara apo të prishura;- të zbatojë procedurat për evidentimin dhe trajtimin e mallrave të skaduar;- të respektojë informacionin e dhënë në etiketa;- të respektojë të drejtat e konsumatorit për sigurinë e produktit;- të përzgjedhë llojet e përshtatshme të paketimit dhe ambalazhimit të produkteve;- të sistemojë produktet në varësi të kushteve të ruajtjes dhe kategorisë së produktit;- të hartojë planin e qarkullimit dhe trajtimit të produkteve;- të zbatojë strategjitë e organizatës për krijimin e ofertave;- të përzgjedhë transportin e përshtatshëm;- të bashkëpunojë me agjencinë e mbrojtjes së konsumatorit. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Nxënësi zbaton rregullat e sigurisë në punë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë të punonjësve;
- të zbatojë rregullat e higjienës;
- të përdorë mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes individuale dhe kolektive;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik për çdo post pune;
- të zbatojë legjislacionin shqiptar të parandalimit, mbrojtjes, neutralizimit dhe shpëtimit ndaj fatkeqësive natyrore, zjarrit etj, si dhe evakuimit të punonjësve;
- të përdorë pajisjet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH);
- të respektojë masat dhe rregulloret përkatëse, gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
- të përdorë manualet e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- të respektojë sinjalistikën në mjedisin e punës;
- të evidentojë shkaqet e aksidenteve në punë dhe masat që duhet të merren për adresimin e tyre;
- të identifikojë faktorët që çenojnë shëndetin e punonjësve;
- të zbatojë standardet për menaxhimin e mbetjeve në vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 3 Nxënësi zbaton parimet e mjedisit të qëndrueshëm.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të respektojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- të identifikojë mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- të raportojë në kohë për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- të zbatojë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- të ndjekë procedurat e sigurimit të ambientit të punës nga vjedhjet/dëmtimet;
- të zbatojë protokollet në raste pandemie dhe katastrofash natyrore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset për praktikant profesional pranë shkollës (zyrat mësimore) apo në mjedise reale pune (biznes).
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të vërë në dispozicion të

nxënësve legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë të punonjësve dhe të parandalimit, mbrojtjes, neutralizimit dhe shpëtimit ndaj fatkeqësive natyrore, zjarrit etj, si dhe evakuimit të punonjësve.

- Nxënësit duhet të përdorin Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së ambientit dhe pajisjeve, gjatë sigurimit të cilësisë së mallrave, në ndërmarrjen tregtare.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë të punonjësve.
 - Legjislacionin shqiptar të parandalimit, mbrojtjes, neutralizimit dhe shpëtimit ndaj fatkeqësive natyrore, zjarrit etj, si dhe evakuimit të punonjësve.
 - Manualet e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës.
 - Materiale kancelarie.
 - Kompjuter.
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli: “Logjistika e eksport-importit.”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV I KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	LOGJISTIKA E EKSPORT-IMPORTIT	M-17-1274-16
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të plotësuar dokumentet e eksport-importit, organizimin e transportit dhe spedicionit në eksport-import, si dhe llogaritjen e çmimeve të transportit të mallrave.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK-së, në drejtimin mësimor “Ekonomi- Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi zbaton procedurat dhe plotëson dokumentet për exportin dhe importin. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë dokumentet e eksportit dhe importit;- të plotësojë deklaratat doganore;- të përpilojë faturat shoqëruese të mallit;- të plotësojë dokumentet e transportimit të mallit -TIR;- të plotësojë certifikatat e origjinës;- të plotësojë dokumentet e eksportit nga vendi i nisjes;- të plotësojë dokumentet e importit në vendin e mbërritjes;- të verifikojë dokumentet e nevojshme për eksport/import;- të përgatisë dokumentet e eksportit dhe importit;- të ketë komunikim korrekt me të tretët. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.	
	<p>RN 2 Nxënësi organizon transportin në eksport-import. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të zgjedhë mjetet transportuse;- të realizojë sigurimin e mallit;	

- të zgjedhë transportin vetiak apo transportin e huazuar;
- të realizojë procesimin në terminal;
- të zbatojë marrëveshjeve ndërkombëtare të transportit;
- të anëtarsohet në TIR konventën;
- të plotësojë TIR karnetin;
- të plotësojë dokumentacionin e duhur në transport;
- të llogarisë çmimet transportuese;
- të realizojë lidhjen e marrëveshjeve dhe kontratave për transport;
- të komunikojë me korrektësi;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 3 Nxënësi organizon shpërndarjen.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndajë përgjegjësitë të shitësit dhe blerësit;
- të kontrollojë rregullsinë e dokumenteve;
- të plotësojë kushtet e dërgesës “incoterms-at”, pasi i ka analizuar mirë ato;
- të zbatojë konventat dhe rregulloret ndërkombëtare të transportit;
- të mundësojë krijimin e lidhjeve me organizata të tjera të spedicionit;
- të pranojë dërgesat;
- të përgatisë dërgesat;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN4 Nxënësi kryen veprimet në magazinë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë këmbimin elektronik të të dhënave për mallrat në magazinë;
- të realizojë mbledhjen automatike të të dhënave për mallrat në magazinë;
- të regjistrojë të dhënat e mallit të magazinës;
- të planifikojë gjendjen e magazinës, sipas mallrave që do të magazinohen;
- të përdorë teknologjinë në administrimin e magazinës;
- të plotësojë dokumentet për pranimin-dorëzimin e mallit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjedise reale të punës në biznes apo mjediset e shkollës (zyrave mësimore).
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet e dokumenteve dhe formularëve, të marrë nga praktika e ndërmarrjeve ekonomike, për të plotësuar dokumentet e eksport-importit, organizuar transportin dhe spedicionin në eksport-import, si dhe llogaritjen e çmimeve të transportit të mallrave.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të mbikëqyrur dhe të pavarur për të plotësuar dokumentet e eksport-importit, organizuar transportin dhe spedicionin në eksport-import, si dhe llogaritjen e çmimeve të transportit të mallrave.
- Nxënësit duhet të përdor Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e RM-ve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së ambientit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjediset e ndërmarrjes tregtare.
 - Materiale kancelarie.
 - Dokumente të ndryshme pune, regjistra, formularë nga ndërmarrjet reale ose të përgatitura nga nxënësit dhe mësuesi në module të viteve të kaluara.
 - Kompjuter i lidhur me internetin.
-

2. Moduli “Hulumtimi i tregut”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	HULUMTIMI I TREGUT	M-17-1275-16
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të realizuar hulumtime dhe studime të tregut, ku do të operojë ndërmarrja tregtare.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në drejtimin mësimor “Ekonomi-Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi mbledh të dhënat për hulumtimin e tregut. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përcaktojë grupin e synuar (target group) për studim;- të përgatisë planin për mbledhjen e të dhënave;- të krijojë grupin e punës;- të ndajë detyrat në grup;- të përzgjedhë metodat kryesore dhe burimet e mbledhjes së të dhënave:<ul style="list-style-type: none">- intervistat personale (me anketim me pyetësorë, me telefon, me postë, me e-mail);- moderimi i diskutimeve në grupe të caktuara;- vëzhgimi i sjelljes së klientëve në treg (i drejtpërdrejtë ose i regjistruar);- informacione të marra on-line (p.sh. nga rrjetet sociale);- eksperimentimi (testimi) i ofrimit të produktit dhe i sjelljes së klientëve;- mbledhja e të dhënave nga burimet zyrtare dhe jozyrtare (publikimet, interneti, televizioni, media e shkruar dhe elektronike etj);- të përgatisë pyetësorët për mbledhjen e të dhënave;- të realizojë me kujdes dhe saktësi intervistimet;- të komunikojë me korrektësi. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RN 2 Nxënësi kryen përpunimin e të dhënave të grumbulluara. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p>	

- të administrojë të dhënat e mbledhura;
- të kryejë përpunimin paraprak të të dhënave, duke i seleksionuar ato;
- të strukturojë të dhënat për të lehtësuar analizën e tyre;
- të realizojë kontrollin logjik të të dhënave;
- të kryejë kodimin e të dhënave;
- të kryejë përpunimin statistikor të të dhënave, në kompjuter;
- të kryejë analizën përmbajtësore të të dhënave;
- të interpretojë rezultatet e hulumtimit;
- të përgatisë përfundimet dhe propozimet e hulumtimit;
- të prezantojë raportin e hulumtimit të tregut, për studimin e rastit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjedise reale të punës në biznes apo mjediset e shkollës (zyrave mësimore).
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të ketë shumë kujdes për të përzgjedhur rastet më të thjeshta, duke mos kaluar kufijtë e kërkuar për nxënës së shkollës së mesme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të realizuar hulumtime dhe studime të tregut, krijuar pyetësorë, realizuar intervista në tregjet ku do të operojë ndërmarrja tregtare.
- Nxënësit duhet të përdor Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së ambientit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjediset e firmës ushtrimore ose të ndërmarrjes tregtare.
 - Mjete kancelarie.
 - Informacione, formularë dhe pasqyra të ndryshme nga ndërmarrjet.
 - Internet.
 - Kompjuter.
-

3. Moduli “Menaxhimi i të dhënave”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MENAXHIMI I TË DHËNAVE	M-17-1276-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të siguruar informacionin nga burime të ndryshme, përpunuar, ruajtur dhe menaxhuar atë, në mënyrë të përshtatshme, në shërbim të ndërmarrjes tregtare.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në drejtimin mësimor “Ekonomi-Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN1 Nxënësi kryen identifikimin e burimeve të të dhënave për ndërmarrjen tregtare. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të identifikojë burimet kryesore të të dhënave për ndërmarrjen tregtare;- të sigurojë informacione sa më të plota dhe të përshtatshme nga kontaktet e vazhdueshme me klientët, furnitorët, investitorët;- të sigurojë informacione sa më të plota nga studimi i tregut;- të hartojë saktë formularë dhe pyetësorë të qartë për sigurimin e informacionit, nëpërmjet fushatave të marketingut;- të kërkojë, gjejë dhe mbledhë informacionin nga burime të ndryshme zyrtare (gazeta, botime ligjore etj);- të identifikojë mediat dhe emisionet nga të cilat mund të sigurohen informacione në interes të biznesit;- të sigurojë informacione nga interneti dhe e-mail;- të hartojë listat e detyrave për sigurimin e informacioneve në vazhdimësi. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit. <p>RN 2 Nxënësi harton planin e menaxhimit të të dhënave. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të planifikojë burimet kryesore të të dhënave në të ardhmen;	

- të planifikojë mënyrat më efikase të organizimit të të dhënave;
- të planifikojë mënyrat e ruajtjes së të dhënave;
- të planifikojë mënyrat e përpunimit dhe analizimit të të dhënave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 3 Nxënësi organizon të dhënat e siguruar.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shqyrtojë me përgjegjshmëri dhe cilësi informacionin e mbledhur, duke veçuar atë të panevojshëm nga ai që do të përdoret në vazhdimësi;
- të grupojë saktë informacionet e mbledhura nga burime të tjera, në varësi të qëllimeve për të cilat mund të përdoret;
- të etiketojë qartë informacionet e mbledhura, që të mund të gjenden sa më lehtë dhe mund të përdoren në vazhdimësi;
- të vendosë informacionin në dispozicion të hallkave të ndryshme të njësisë tregtare të cilave mund t'u nevojitet;
- të krijojë arkivë të organizuar në mënyrë të përshtatshme për ruajtjen e informacioneve të shkruara;
- të krijojë një bibliotekë të organizuar dhe lehtësisht të përdorshme nga të gjithë të interesuarit, për informacionet zyrtare dhe legjislacionin në ndërmarrje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 4 Nxënësi përpunon të dhënat për ndërmarrjen tregtare.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë programet dhe metodat më efikase për përpunimin e të dhënave;
- të përpunojë të dhënat në Excel;
- të kryejë analizat e nevojshme për biznesin;
- të ndërtojë tabela, diagrama dhe grafikë për kryerjen e analizave;
- të nxjerrë dhe komentojë rezultatet e dala nga përpunimi i të dhënave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit

RN 5 Nxënësi administron bankat elektronike të të dhënave.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë kriteret e qarta, mbi bazën e të cilëve do të kërkohet informacioni nga banka elektronike e të dhënave;
- të përcaktojë një renditje domethënëse dhe të qartë të

- informacionit në bankën e të dhënave;
- të mbartë me saktësi informacionin në bankën e të dhënave;
- të vendosë lidhje në rrjet për përdorimin e bankës elektronike të të dhënave;
- të përdorë saktë bankën elektronike të të dhënave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjedise reale të punës në biznes apo mjediset e shkollës (zyrave mësimore).
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur dokumentet dhe shembujt konkretë mbi menaxhimin e të dhënave.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të siguruar, përpunuar, administruar informacione të ndryshme dhe menaxhuar të dhënat e nxjerra nga këto informacione, të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për sigurimin, përpunimin dhe administrimin e të dhënave.
- Nxënësit duhet të përdor Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për sigurimin e të dhënave, organizimin dhe ruajtjen e tyre si dhe përpunimin dhe analizimin.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së ambientit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjediset e ndërmarrjeve të ndryshme.
 - Materiale kancelarie.
 - Kompjuter me lidhje Interneti.
 - Programe për përpunimin e të dhënave.
 - Informacione të shkruara, ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme.
-

4. Moduli “E-Tregti”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV I KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	E-TREGTI	M-17-1268-16
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të krijuar dhe menaxhuar një biznes on-line.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II, të KSHK, në drejtimin mësimor “Ekonomi-Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi ndërton një faqe interneti (website). <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të identifikojë llojet e ndryshme të website-ve të disponueshme;- të identifikojë faqe, të cilat përmbajnë informacion të përshtatshëm;- të zgjedhë platformën më të përshtatshme për llojin e biznesit;- të krijojë strukturën e website;- të vendosë përmbajtjen e website. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.	
	<p>RN 2 Nxënësi menaxhon produktet dhe klientët on-line. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të sigurojë hyrjen në faqen e internetit të biznesit;- të kontrollojë katalogun e produkteve;- të kontrollojë gjendjen në magazinë të produkteve që tregtohen;- të konfigurujë metoda të ndryshme të pagesës;- të konfigurujë metodat dhe afatet e dërgimit të produkteve;- të komunikojë me klientët në lidhje me kërkesat e tyre. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.	
	<p>RN 3 Nxënësi kryen blerje on-line. <i>Kriteret e vlerësimit:</i></p>	

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë faqet ku do të kryhen blerje;
- të hyjë në faqet e bizneseve nga të cilat do të kryhen blerje;
- të krahasojë ofertat për mallrat dhe kushtet përkatëse të lëvrimet/pagesës;
- të identifikojë mallrat/shërbimet që do të porositen;
- të kryejë porosinë për një produkt të caktuar;
- të printojë porosinë e kryer;
- të regjistrojë porosinë në regjistrin e porosive;
- të përdorë mjete të ndryshme elektronike për të kryer pagesën (kartë debiti, kartë krediti, transfertë bankare etj).

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 4 Nxënësi promovon biznesin e tij on-line.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë klientët kryesorë potencialë të biznesit;
- të kontaktojë klientët potencialë nëpërmjet e-mail;
- të optimizojë vitrinën on-line;
- të vendosë oferta në faqe;
- të promovojë biznesin në rrjetet sociale;
- të kryejë sondazhe on-line mbi preferencat e konsumatorëve;
- të përgatisë pyetësorë për vlerësimin e faqes dhe produkteve nga klientët;
- të analizojë rezultatet e pyetësorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

RN 5 Nxënësi kryen shitje on-line.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kontrollojë porositë e ardhura në faqen e biznesit;
- të kalojë porositë për përpunim;
- të regjistrojë porositë në regjistrin e porosive;
- të dërgojë konfirmime për marrjen e porosisë;
- të ruajë në mënyrë elektronike porosinë;
- të pranojë metoda të ndryshme të pagesës dhe t'i kontrollojë ato;
- të kryejë procedurat për dërgimin e produkteve të porositura.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset reale të punës, në biznes apo mjediset e shkollës (zyrave mësimore).

dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shembuj konkretë dhe të nxisë kreativitetin e nxënësve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të krijuar dhe menaxhuar biznesin e tyre on-line, të nxiten, të diskutojnë dhe bashkëpunojnë në lidhje me proceset e punës për krijimin e një pikë shitjeje on-line, menaxhimin e klientëve dhe produkteve on-line, kryerjen e blerjeve, shitjeve on-line, promovimin e biznesit on-line.
- Nxënësit duhet të përdor Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin me të tjerët.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për krijimin dhe menaxhimin e një biznesi on-line.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
- Mësimdhënësi/mentori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së ambientit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Materiale kancelarie.
 - Kompjuter me lidhje Interneti.
 - Programe e-commerce.
 - Informacione mbi tregtinë on-line
 - Legjislacioni mbi tregtinë on-line.
-

5. Moduli “Marketingu dixhital”

Drejtimi: Ekonomi-Biznes
Profili: Tregti
Niveli : IV i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	MARKETINGU DIXHITAL	M-26-1580-19
Qëllimi i modulit	Një modul që pajis nxënësit me njohuritë dhe aftësitë bazë për të mundësuar marketingun e biznesit përmes teknikave të ndryshme dixhitale.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në drejtimin mësimor “Ekonomi-Biznes”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi përzgjedh platformën dixhitale dhe mediat sociale për promovimin dixhital. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë produktin të cilit do t'i bëhet marketingu.- të analizojë veçoritë e kategorive të klientëve të mundshëm të produktit;- të identifikojë lloje të ndryshme të platformave dixhitale dhe mediave sociale;- të analizojë kriteret për përzgjedhjen e platformës dixhitale dhe medias sociale;- të përzgjedhë platformën dixhitale dhe median sociale;- të prezantojë platformën dixhitale dhe median sociale të përzgjedhur. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RN 2 Nxënësi përgatit materialet për hedhjen e tyre në platformën dixhitale dhe median sociale. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatitë materiale të ndryshme interaktive (tekst, imazh, video etj);- të ndërtojë video, duke përdorur programe (software) të ndryshme (psh. <i>Movie maker</i>, ose nëpërmjet aparatit celular, <i>smartphone</i> etj);- të modifikojë imazhe të ndryshme me <i>software</i>, <i>photoshop</i>, <i>canva</i> etj;- të ngarkojë (publikojë) materialet e mësipërme në	

platformën dixhitale dhe median sociale të përzgjedhur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi menaxhon platformën dixhitale e mediat sociale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë gabimet e mundshme në materialet e ndryshme interaktive të hedhura në platformën dixhitale dhe median sociale;
- të modifikojë materialet e ndryshme interaktive (tekst, imazh, video etj), në rast gabimesh;
- të fshijë materiale interaktive të panevojshme në platformën dixhitale dhe mediat sociale;
- të realizojë komunikimin dixhital me ndjekësit/klientët, përmes internetit/mesazheve në inbox ose komenteve të ndryshme për materialet e publikuara në platformën dixhitale;
- të monitorojë impaktin e mesazhit të kompanisë te ndjekësit/klientët;
- të nxitë ndjekësit/klientët që të veprojnë në përgjigje të mesazhit të kompanisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi përgatit raporte të dhënash mbi përdorimin e platformës dixhitale dhe mediave sociale nga ndjekësit/klientët.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë numrin e vizitorëve të platformës dixhitale dhe mediave sociale;
- të ndërtojë një paraqitje grafike mbi numrin e vizitorëve që aksesojnë platformën dixhitale dhe mediat sociale (ditore, javore, mujore);
- të evidentojë elementet psikologjike të *Marketingut Super Efektiv*, nëpërmjet internetit/rrjeteve sociale (të cilët bëjnë diferencën midis një fushate të pa-suksesshme dhe një fushate jashtëzakonisht të suksesshme);
- të analizojë rolin e menaxherit të platformës dixhitale dhe mediave sociale, duke u bazuar tek numri i personave që i aksesojnë ato.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi krijon një plan marketingu dixhital.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë një plan orar, ditore dhe javor në lidhje me

publikimin/shpërndarjen e informacioneve të ndryshme në platformat e përzgjedhura;

- të krijojë fushata marketingu dixhital, duke përdorur burime të ndryshme reklamimi (rrjetet sociale, e-mail ose *mobile marketing*);
- të identifikojë fushata fituese, si dhe të mirëmbajë fushatat ekzistuese të marketingut për sukses maksimal;
- të sugjerojë, nëse është e mundur, zgjidhje të mirëfillta, të shumëllojshme dhe të mirë analizuara për arritjen e perceptimit të mesazhit deri tek audienca e synuar dhe konsumatori final.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset reale të punës, laboratorë të TIK, në biznes apo mjediset e shkollës.
- Ky modul kërkon, që rezultatet mësimore të realizohen online.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shembujt konkretë dhe të nxisë kreativitetin e nxënësve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, duke rritur angazhimin e vizitorëve në faqe, duke përgatitur shkrime interaktive, të krijojnë video promovuese, të masin efikasitetin e marketingut dixhital etj.
- Nxënësit duhet të nxiten të diskutojnë dhe bashkëpunojnë në lidhje me proceset e punës për krijimin e një plani marketingu online.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për krijimin dhe menaxhimin e marketingut dixhital.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise pune me kompjutera dhe lidhje interneti.
 - Programe të ndryshme kompjuterike për realizimin e marketingut dixhital.
 - Materiale kancelarie.
 - Pajisje për përgatitjen e materialeve promovuese.
 - Informacione mbi marketingun dixhital.
 - Legjislacioni mbi marketingun dixhital.
 - Materiale udhëzuese.
-